



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. 12-060-14738 dt. 23. 04 2020

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Labinot Halilaj, më datë: 30/04/2020 (e Enjte) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET


MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 28.02.2020.
2. Propozim Vendim i statutit për ndërmarrjen publike Lokale "Stacioni i autobusëve", SH. A. në Drenas-Glllogoc.
3. Propozim Vendim për formimin e komisionit për vlerësimin e pronave që mund të këmbehen dhe dhënien e rekomandimeve për pronat që duhet të shpronësohen në parcelën 743/1, në zonën e kadastrave Drenas.
4. Diskutim rreth situatës emergjente e krijuar nga COVID-19, dhe mundësit e ndarjes buxhetore për tejkalim të situatës në Komunën e Drenasit.
5. Të ndryshme.

Drenas, 23.04.2020



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr 12-060/201-14051 dt. 20-03 2020

Mbledhja e rregullt
Kuvendi Komunal
28. 02.2020

PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: 28.02.2020

Mbledhjen e kryesoi: Gani Podrimqaku- asambleist, në mungesë të Kryesuesit Z. Labinot Halilaj.

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të rregullt të Kuvendit Komunal ku të pranishëm ishin 30 anëtarë .

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

- 1.Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 24.01.2020.
- 2.Propozim Vendim për miratimin e Propozimit Profesional për Shpalljen e Lokalitetit të Boshtres (Forsythia europaea) në Golesh si monument i mbrojtur i natyrës për arealin e kësaj bime (Sankos) në pjesën e Komunës së Glllogocit.
- 3.Rregullore për Organizimin e Punës në institucionet Edukativo-Arsimore në Komunën e Drenasit.
- 4.Raporti vjetor i punës së Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale për vitin 2019.
- 5.Propozim vendim për miratimin e Statutit të ri të QKMF-së Drenas.
- 6.Draft-Propozim për ndryshim-plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngastra dhe Gjoba 2020. E plotësuar.
7. Propozim vendim për caktimin e qirase profitabile për përfituesit e programit të veçantë të banimit.
- 8.Të ndryshme

Prezent gjatë mbledhjes së rregullt të datës 28.02.2020 ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, nënkryetari i Komunës z. Nazmi Hasi, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të OSBE-së, zyrtar të Komunës, 29 anëtar të Kuvendit Komunal, z. Gani Podrimqaku asambleist i cili Udhehoqi seancën, në mungesë të kryesuesit të Kuvendit Komunal z. Labinot Halilaj.

Z.Gani Podrimqaku- pasi përshendeti të gjithë deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, i njoftoi me rendit të ditës dhe njoftoi se Drejtori i Shëndetësisë e ka edhe një pikë shtesë: Propozim vendim për caktimin e qirase profitabile për përfituesit e programit të veçantë të banimit.

Drejtori i Shëndetësisë Arsim Haxhiu- e kemi edhe një pikë shtesë: Propozim vendim për caktimin e qirase profitabile për përfituesit e programit të veçantë të banimit. Kekroj që këtë propozim vendim me e shti në rend dite, ju ftoj ta votoni.

Z.Gani Podrimqaku- me këtë pikë shtesë hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë takimit ishin 28 anëtar:

Për votuan 27 anëtar

Kunder nuk pati

Abstenim 01.

Z.Gani Podrimqaku- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 24.01.2020.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime z.Gani Podrimqaku hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar:

Për votuan 27 anëtar

Kunder nuk pati

Abstenim votuan 1 anëtar.

Z.Gani Podrimqaku- hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Propozim Vendim për miratimin e Propozimit Profesional për Shpalljen e Lokalitetit të Boshtres (Forsythia europaea) në Golesh si monument i mbrojtur i natyrës për arealin e kësaj bime (Sankos) në pjesën e Komunës së Gllogocit.**

Drejtoresha për Planifikim Hapsinor Flutura Avdiu- para jush e kemi Propozim Vendim për miratimin e Propozimit Profesional për Shpalljen e Lokalitetit të Boshtres (Forsythia europaea) në Golesh si monument i mbrojtur i natyrës për arealin e kësaj bime (Sankos) në pjesën e Komunës së Gllogocit, njoftoi se për hartimin e arsyeshmërisë profesionale për shpalljen e lokalitetit të Boshtres (Forsythia europaea) në Golesh si Monument i mbrojtur i natyrës, Agjencisë për Mbrojtje të Mjedisit të Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me vendimin Nr.7519.18 të datës 17.12.2019, ka formuar Grupin punues nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, në këtë përbërje:

Qenan Maxhuni, IKMN- kryesues

Valmira Gashi, DMMU- anëtar

Elez Krasniqi, Prof Asoc. Dr. Departamenti i Biologjisë, FSHMN, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”- anëtar

Adnan Bullatovci, Komuna Fushë Kosovë- anëtar

Bajram Sinani, Komuna Lipjan- anëtar

Haki Bekolli, Komuna Gllogoc- anëtar

Përparim Gashi, SIM- anëtar

Pas hartimit të propozimit profesional për shpalljen e lokalitetit të Boshtres (Forsythia europaea) në Golesh si Monument i mbrojtur i natyrës nga grupi punues i formuar sipas vendimit Nr.7519/18 të datës 17.12.2019, nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.

Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, me Propozimin 08-Nr.03070788 dt. 13.12.2019, duke u bazuar në Vendimin e Agjencisë për Mbrojtje të Mjedisit të Kosovës të MMPH-së me nr.7518/18 të datës 19.12.2018, për Hartimin e arsyeshmërisë profesionale për Shpalljen e lokalitetit të boshtres (Forsythia europiana) Golesh si monument i mbrojtur i natyrës të paraqitur të Kryetari i Komunës, është kërkuar të merret vendim për lejimin e hapjes së konsultimit publik për Propozimin Profesional për Shpalljen e lokalitetit të boshtres (Forsythia europiana) Golesh si monument i mbrojtur i natyrës për arealin e kësaj bime në Sankoc, në pjesën e komunës së Glllogocit të punuar nga grupi punues sipas vendimit të lartëshënuar.

Kryetari i Komunës, pas shqyrtimit të propozimit 08-Nr.030-70789 dt. 13.12.2019, paraqitur nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (GZ Nr.28/2008), nenin 72 të Statutit të Komunës së Glllogocit 01-Nr.110-6904 dt. 24.09.2008, ka marrë Vendim me të cilin Lejohet fillimi i procedurave për hapjen e konsultimit publik për Propozimin profesional për shpalljen e lokalitetit Boshtres (Forsythia europaea) në Golesh, pjesë e fshatit Sankoc, Komuna e Glllogocit- "Zonë e Mbrojtur në Kategorinë e Monumentit të Natyrës". Në bazë të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Glllogocit 01-Nr.070-71395 të datës 17.12.2019, për lejimin e hapjes së konsultimit publik për Propozimin Profesional për shpalljen e lokalitetit të Boshtres (Forsythia europaea) në Golesh si Monument i mbrojtur i natyrës për arealin e kësaj bime (Sankoc) në pjesën e Komunës së Glllogocit të punuar nga grupi punues, është publikuar Njoftimi për Shpallje Publike në të cilën janë ftuar dhe njoftuar qytetarët për të shprehur mendimet për Propozimin Profesional për shpalljen e lokalitetit të Boshtres (Forsythia Europaea) në Golesh si Monument i mbrojtur i natyrës duke ndihmuar në dhënien e mendimeve, sugjerimeve, komenteve e vërejtjeve për këtë propozim dokument në afat prej 30 ditësh nga dita e hapjes së konsultimit publik.

Vehbi Berisha- cilat janë obligimet ligjore të Komunës së Drenasit në raport me këtë sepse e shikova se ishin edhe dy komuna tjera dhe cilat janë ndalësat tona si komunë pasi ta votojmë këtë propozim vendim qfar ndalesa do të ketë në këtë zonë ?

Drejtoresha për planifikim Hapsinor Flutura Avdiu- obligimet e komunës kryesisht ishin këto që i përmenda më heret ku fillojnë konsultimet publike, ta shpallim në miratim, qdo komunë ka shkuar paralel për me e miratu si zonë të mbrojtur, pastaj të pjesa e obligimeve ligjore është kjo pjesë ndersa të pjesa tjetër pas marrjes së pelqimit dhe pasi të konfirmohet nga MAPL-ja dhe dhenien e pelqimit për kategorizim atëher duhet ta përcjellim një raport të detajuar lidhur me ato qka i kemi në përsiper, ende nuk e kemi të qartë vetem se duhet filluar me procedurat e miratimit për me u shpall monument i mbrojtur i natyres.

Nexhmedin Balaj- edhe unë jam rreth implikimeve që do të vinë pas miratimit të këtij propozim vendimi, mua me shqetesoj fakti se ajo zonë përdoret shumë edhe për kullosa, a do të ndalohen edhe kullosat në atë zonë?

Drejtoresha për planifikim Hapsinor Flutura Avdiu- këto pyetje do t'i adresoj të gjitha tek zyrtari përgjegjës i ministrisë Qenan Maxhuni, se a do të lejohet për kullosa, besoj që nuk është në afersi të bimës ajo pjesë, ata e kanë specifikuar vetem pjesën tek gurthysi afer monumentit të mbrojtur i natyres ndersa për pjesën tjetër nuk kemi një përgjigje të tillë!

Sokol Bylykbashi- sa i përket ketij dokumenti profesional po besoj se është e qartë dhe u ngrit ketu si pyetje se qka duhet me bo komuna në lidhje me këtë qeshje, po besoj se kjo është e qartë dhe e keni të fq 20 pesë masa që i ndermerr komuna, dhe këto masa duhet me i ndermarë. E pati një pyetje: sa i përket bimës cila është vlera e kësaj bime? Dhe një qeshje që dua ta griti në raport thuhet që afer kesaj zone një operator ekonomik që e ka shfrytezu atë pjesë e ka lënë parcelen ne gjendje që bic ndesh me ligjin, qka mundet për të bërë komuna në raport me atë operator të papëgjegjshem ekonomik që e ka lënë atë parcelle ne atë gjendje jo të mirë, pra a mundet komuna me ndermarë diqka?

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci- ne operatorit bashk me juve qe ia kemi marrë atë parcelle për të cilen e ka shfrytezuat në mënyrë të eger e ka shfrytezuat në mënyrë të kunderligjshme dhe e kemi dërguar në proces gjygesor është nën hetime, siç edhe ai njëkohësisht na ka dergu në Ministri të Pushtetit Lokal, ne e kemi padit edhe në konteskt civil për ta kompenzuar gjithë atë dëmtim që ia ka bërë komunës.

Drejtoresha për planifikim Hapsinor Flutura Avdiu- karakterisitika e kësaj bime si momunemt i mbrojtur i natyres nga eksperetet e ministrise se mjedisit kanë thënë se menyra e shtrirjes se kësaj bime është nje karakteristike e veqante, dobitë e saj janë kryesisht te natyres mjekesore është një bimë sheruese, menyra se si është shtrire tek pejsa e Sankocit e bënë më të veqantë dhe e bënë me të veqante dhe e kanë paraparë me e shpallë këtë si zone të veqant.

Z. Podrimqaku hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 27 anetar:

Për votuan 22 anetar

Abstenim05

Kunder nuk pati.

Z. Podrimqaku -hapi diskutimin për piken e tretë të rendit të ditës: **3.Rregullore për Organizimin e Punës në institucionet Edukativo-Arsimore në Komunën e Drenasit.**

Beqir Kiqina - pasi përshendeti të gjithë, sa i përket kësaj rregullore kisha pas shumë qeshje me grit por e përgezoi drejtorin e Arsimit paqi që ka insistuar me e formu një rregullore të re për Organizimin e Punës në institucionet Edukativo-Arsimore në Komunën e Drenasit, pasi që e dimë që arsimit ne Drenas ballafaqohet me probleme të ndryshme, e njeri ndër problemet kryesore janë emerimet e drejtoreshave të një pas njeshem të ngarim shkarkimit në mënyra të ndryshme por që nuk e kanë pas guximin deri më tani me u marrë me problemet aktuale që po ballafaqohet arsimit në Drenas, i kemi skandalet e njepasnjeshe, që nuk dua të hyjë në thelb t'i përmendi sepse opinioni publik i dinë të gjitha. Sa i përket organizimit dhe të këtij propozim vendimit shpresoj që shumica e kuvendareve janë për sepse jemi të interesuar që në komunën tonë të organizohet të sistemohet në bazë të rregullave, normave ligjore juridike, siç janë të propozuara edhe nga ministria e Arsimit edhe nga rregulloret e Kuvendit Komunal, unë i kam disa qeshje si kërkesë me i adresu tek Drejtoria për Arsim për problemet në të cilën ballafaqohet Drenasi: 1. Organizimi i Arsimit në komunën tonë, kemi pas shumë probleme me mënyren e organizimit, e dimë që komuna jonë se pari për me organizu një sistem të mirëfillt arsimor duhet që më i kry obligimet e veta ndaj operateve ekonomik, që është një borgj i vazhdueshem që komuna i ka mbet operateve ekonomik të cilët kanë transport dhe i kanë bart nxenesit për në shkollë- shtëpi transportin, kjo është një borgj i komunës i cili me u adresu dhe duhet me iu pagu atyre kompanive të cilat janë marrë me këtë qeshje, kemi nderhyrjet politike dhe emerimet, të gjithë e dimë se për me u organizu një sistem i mirëfillt arsimor në komunën duhet me iu ik sa ma shumë emerimeve politike naper shkolla, ne vitin e kaluar e kemi pas nje problem të cilin kouna e Drenasit është vanuar shumë për ngrohje në shkolla në Komunën tonë dhe për shkak të qeshjeve te prokurimit është vanuar hapja e tenderit dhe disa ditë nxenesit kanë mbet pa ngrohje, janë ndërhyrjet politike të vazhdueshme, emerimet e drejtoreshave, mos respektimi i propozimeve nga MASHT-i mos llogaridhënia janë probleme të vazhdueshme të cilat komuna nuk e ka

sjellë ndonje raport se qka veprojnë shkollat tona, qfare mesimdhenes japin mesim te cilet janë me aktakuza dhe ende nuk kanë marrë masa ndaj atyre, shumë probleme të organizimit të arsimit i kemi në këtë komunë, shpresoj se të gjitha kemi me e dhënë voten për këtë propozim dhe me bërë diqka që me ndryshu dhe mos mendoni me iu ik përgjithesive të cilat i ka pas ky ekzekutiv dhe nuk ka rregulluar asgjë!

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrocy- mos fol kot me thënë i ka shkarku ne mënyra të ndryshme drejtoret, më thuaj vetem një shkarkim vetem një emer dhe pajtohem me atë që e thua ti. Borgj të transportit publik ceke sepse komuna nuk i ka borgj askujt, ne e kemi për obligim me i pagu borgjet. Puna e nxemjes vitin e kaluar nuk është ashtu siq e ceke. Sa i përket aktakuzave të mesimdhensve që kanë aktakuzë seksuale, ceke kush janë ata dhe sigurisht që do të marrim masa menjehere dhe sigurisht që merr vendimin brenda momentit të pare.

Drejtori i Arsimit Muhamet Gjoka- i përshendeti të gjithë, besoj që të gjithë pajtoheni që shkollave në Komunen tonë i ka munguar një rregullore e tille dhe është e domosdoshme që ta kemi në përdorim sa më shpejt, ju ftoj ta mbeshtetni këtë rregullore, i mirëpres komentet, sugjerimet, kritikën. Ne nuk i frikesohemi kritikave sugjerimeve verejtjeve sepse jemi të interesuar jashtëzakonisht shumë për ta avancuar nivelin e arsimit në komunën tonë. Sa i përket transportit e kemi me kontrate dhe jeni të obliguar ligjerisht me iu përmbajtë kontrates, ndersa ndonje herë për shkak të alokimit të mjeteve mund te ketë vonesa akutale mirepo obligimet janë kontraktuale dhe nuk kemi mundesi me iu ik këtyre obligimeve, ne jemi këtu për ta zbatuar kontaten në përgjithesi. Sa i përket emerimeve politike e kemi pas një nderrim të drejtorit që i ka skadu mandati, dhe tani atë që e kemi marrë është ushtrues detyre, dhe nuk ka lidhje me politiken është një profesionist dhe realisht është ushtrues detyre. Siq jeni në dijeni draft rregullorja është punuar prej 7 anetareve dhe ky komision për një kohë të gjatë ka punuar në këtë draft rregullore dhe janë konsultuar gjitha bazat ligjore, udhezimet administrative janë konsultuar gjitha rregulloret e komunave tjera dhe besoj që është rregullore është rregullorja më e agjruar në këtë aspekt sepse shumica e rregulloreve të qyteteve tjera janë përpiluar ma heret dhe në aspektin kohor jemi në konform legjisacionit në fuqi.

Sabrije Kukaj- unë jam pjesë e hartimit të rregullores, kërkesa në komision për rregullore ka qenë me u fut edhe ligji për arsimin parauniversitar për kodin e veshjes dhe miresjelljes në shkollë për ciklin arsimor, kjo pikë është heq, dhe unë nuk dua të jem pjesë e rregullores kur i heqni disa pjesë, unë nuk dua të jem pjesë e nje komisioni ku po i hiqni këto pjesë, sot po terhiqna nga punimi i kesaj rregullore, une kisha dasht me fol për shujten qe paskemi me harru me e fut në rregullore, e mos me dal nxenesit nga oborri i shkollës me shku naper markete, u dasht me e fut shujten për nxenes, ligji për arsimin parafillor neni 3 pika 7, është heq nga kjo rregullore kodi i veshjes dhe sjelljes së puntoreve të arsimit naper shkolla unë nuk jam pjesë e kesaj rregullore më, por rregullorja duhet të jetë mirë e përpiluar duhet të jenë gjerat që na brengosin.

Kimete Bardhi- pasi përshendeti të gjithë, dua të ndalem tek neni 33 dhe neni 42, e dimë që krahas drejtave të nxenesve, nxenesi ka edhe obligime që janë të cekura edhe këtu, dua të ndalem vetem tek pika 33.4 ku thotë të vishet në përputhje me normat pedagogjike arsimore të Republikës së Kosovës dhe të bartë uniformen nese ka, unë përderisa jam në këtë proces arsimor, barjen e uniformes e kisha bërë të obligueshme, gjatë oreve të mesimit të këtë përgaditje të duhura për qdo orë mësimore, dhe përgaditjet e duhura të ora e ed. Fzike dhe sportive, tek kjo orë e kisha bërë të obligueshme që nxenesi me qenë i paisur me trinerka dhe me atletë. Neni 42 thuhet detyrat dhe përgjithesitë e mesimdhenesit kujdestar të klasës, po flas për klasen e 6-9, na nuk kemi orë të veqantë të kujdestarisë, unë propozoj që me qenë orë e veqantë e kujdestarisë të klasës, edhe të ndarja e kujdestareve të klasës e dim psh i kemi mesimdhënës që kanë orë me shumë brenda javës janë mesimdhenesit e matematikës e gjuhes që i kanë nga 5 orë atyre

dmth iu bjen që qdo ditë me qenë në shkollë dhe ne e dimë se cili është efekti i kujdestarit të klases, kështu që ne nuk mundemi me e percaktu një kujdestar të klases ne qofte se ai e ka një orë brenda javes sepse roli i tij humb tek nxenesi.

Nënkryetari i Komunës z. Nazmi Hasi- kam qenë i inkorporuar në shqyrtimin e kësaj rregullore që e keni para vites, të gjithë po pajtohem se kjo rregullore është hapi parë që mundeson funksionimin efikas normal të procesit edukativo arsimor, mesuesja Sabri e potencoj se është menjëherë neni që ka të bëjë me veshjen dhe dukjen e nxenesve dhe mesimdhënësve mirepo ai nen por edhe rregullorja e përgjithshme, të gjitha nenet janë në formë të përgjithësuar pastaj ekzistojnë dhe duhet t'i marrim edhe hapat tjerë të cilët parashohin edhe aprovimin e 14 rregulloreve tjera, sa i përket veshjes dhe dukjes ne duhet ta përpilojmë hapin tjetër kodin e etikës si për nxenes ashtu edhe për mesimdhënës, kështu që baza është vënë nëse aprovohet sigurisht, neve na pret edhe një punë tjetër e madhe edhe në përpilimin e 14 rregulloreve tjera me karakter lokal me specifikat e shkollave.

Arta Xhyllani- pasi që kam qenë edhe unë pjesë e komisionit, janë disa gjera që duhet me u ndryshu që ka të bëjë me kujdestarinë, kjo pjesë e kujdestarisë u dasht me u rishqyrtua për shkak se neni 66, nese nuk mbahet kujdestaria iu hiqet 2.5 % të pages nese nuk e mban kujdestarinë pastaj ka qene edhe një problem tjetër 3 % e pages bazë t'i hiqen nese nuk i plotëson librin amez apo dëftesat edhe këtu e kemi pas si propozim për me e hek këtë përqindje për arsye se nese kujdestari i klases nuk dëshiron me e plotësu këtë është shumë e thjeshtë sepse 3% e pages bazë është shumë pak për një profesor dhe mund ta tërheq këtë pjesë është pjesë shqyrtuese e neni 26 të aktiviteteve profesionale rendore kisha propozu se e di që me rregullore ndoshta është e ndaluar mirepo duke pas parasysh komunën tone që nuk ka shumë pjesë turistike ose edhe ato që duhet me i vizitu nxenesit, shtesa që duhetme ia bë është me kërkesen ose me dijenin e drejtorit të bëhën vizita studimore edhe jashtë komunës për shkak se e kemi rastin nese ne bazohemi në këtë rregullore ka qenë rregullorja e Prishtinës, e kemi pas kërkesë edhe neni 27 komisioni disiplinor që prindi të hiqet nga komisioni disiplinor sepse mund të shkaktoj ndonjë qasje indirekte që mund t'i shkaktoj këtij komisioni për nxenesit që do të rrjedhin, si dhe është neni 36 derisa të nxenesit i keni thënë që nxenesi duhet të jetë se paku 10 min para kohë në shkollë, mesimdhënësit i kemi dhënë obligim të paraqitet në shkollë 15 minuta. Dhe kodi i veshjes e kemi cek që me qenë ligji parauniversitar neni 3 pika 7 ju e kemi heq.

Drejtori i Arsimit Muhamet Gjoka - ne nuk e kemi larguar atë pikë të ciles iu referuat tani, vetem nuk e kemi cek decidivishtatë pikë por e kemi marrë vetem udhëzimin dhe komplet kushtetutet ligjet që janë në fuqi, dmth nuk e kemi larguar sepse ka edhe qështje tjera me pika tjera që rregullohen dhe e kemi konsideruar se në aspektin ligjor nuk jemi në rregull nese referohemi vetem tek një pikë, ka edhe rregullore dhe qështje tjera që janë me interes për procesin edukativo arsimor. Sa i përket kërkesës apo deklarimit public që keni qene pjesë e komisionit ju falenderoj që keni dhënë kontribut në këtë rregullore komisioni ka qenë i përbërë prej 7 anetareve dhe me shumicë vota qsh janë vendos keto ndryshime për të cilat i diskutuat më heret. Ndersa pikës tjetër vetem 3% për mos plotësim të ditarit që që I bie saktësisht që I bie 12, e kemi cek aty kemi thënë vetem nese nuk plotësohet me kohë, sepse plotësimi i ditarit është i domosdoshem, sa i përket kujdestarisë janë të rregulluara me udhëzim administrativ kjo qështje është e ngrit nga MASHT sepse ne nuk mundemi me shtu diqka ose me hek nese është në kundërshtim me udhëzime administrative. Sa i përket pikës tjetër për vizita jashtë Komunës së Drenasit, pajtohem plotësisht udhëzimi administrativ e specifikon sakt për nivelin fillor vizitat lejohen vetem brenda territorit të komunës, kjo ka qenë arsyeja sepse kemi pas kërkesa nga mesimdhënësit për vizite jashtë komunës mirepo bie ndesh me udhëzimin administrativ dhe ne nuk kemi pas mundësi me dhënë pelqime për vizita të tilla.

Sabrije Kukaj - sa i përket kujdestarisë e kemi diskutuar se ora e kujdestarie ka implikime buxhetore , dhe e rrit numrin e punetoreve në arsim gjë që nuk është e mundshme, kodin e veshjes apo uniforma të nxenesit prej klases 1- deri në klasen e 9 është dhënë, ndërsa për shkolla të mesme nuk po flas asgjë sepse secila shkollë munden me të rregullore të brendshme në shkollë.

Petrir Gashi - sa i përket rregullores në fshatin Arllat e kam shkuar vet në shkollë një nxenes me nevoja të veqanta dhe mesimdhënesit i duhet të rrij gjithë kohën në klasë nuk mundet më e shfrytëzu as pushimin e shkurtër as pushimin e gjatë dhe të rrij në klasë si rezultat i përkujdesjes për atë nxenes, nuk e keni përfshi kështu përkujdesjen për nxenes me nevoja të veqanta e keni në shkollën e Arllatit "Abedin Bujupi" Ndersa të ora e kujdestarisë e ceket më heret e thotë që ka implikime buxhetore dhe për këtë arsye nuk e keni fut orën e kujdestarisë, mirepo nese nuk kemi orë kujdestarie si mundemi me i sanksionu si mundemi me i denu ne ata mesimdhënes kur nuk e kemi definuar një orë të qartë si orë e kujdestarisë. Sa i përket rregulloreës te neni 18 pika 4, pushimi i gjatë gjatë orarit zgjatë 20 min tek shkollat me një nderrim ndërsa tek shkollat me dy nderrime orari i pushimit zgjatë 15 min, më mirë me i bërë për të gjithë 15 min që mos me iu bërë diskriminim këtyre tjerëve t'i bëjmë të parabartë për të gjithë. Te neni 19 të kështilli drejtues i shkollës i kemi bërë i kemi bërë dy nene neni 19 dhe 20 psh te pika parë të neni 19 dhe neni 20 ne mundemi me i involvu me një nen për shkak se flet për të njëjten gjë, dhe të neni 24 dhe 25 po e shoh se i referohet të njëjtat përgjithësi, gjithashtu dhe të komisioni disiplinor te neni 27 dhe 28 pra nese flasim për komisionin disiplinor dhe drejtori që i dergon rastet në komision mendoj se duhet me i specifiku apo me i bërë me një nen sepse po flasim për të dyja që i kanë të njëjtat probleme, edhe të neni 37 dhe 38 është i njëjti, të neni 58 e kemi bërë 58.1.2.3 pasi që nuk kemi sqarim për të gjitha këto forma mendoj se duhet me shkru në vazhdimësi këto janë gabime teknike po mendoj se më mirë më i shiku me kohë , edhe të neni 66.10, dhe të procedurat arkimore na u kanë përzi nenet 72 kemi dal neni 75 ka gabime teknike që duhet t'i rregullojmë, në fund neni 73,74,75, 76,77 kështu me radhë që duhet me i rregullu pjesën përfundimtare.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovë – kërkoi falje publike për ngatërrimin e neneve sepse zyrtari z. Hazir Elshani thot se iu ka ndal rryma dhe ka pas defekt kompjuteri dhe e kemi përmiresuar.

Nenkryetari I Komunës se Drenasit Nazmi Hasi- neni 19-20, neni 19 ka kuptimin apo funksionin mbi domosdoshmerinë e krijimit të kështillit drejtues ndërsa neni 20 e ka për detyrë përgjithësitë detyrat dhe të gjitha obligimet që do t'i ketë kështilli drejtues konform ligjit 17 për arsimin parauniversitar këto duhet të qendrojnë të fusionuara për faktin se neni 19-20 do të na mundesojnë në kuptimin juridik që t'i përpilojmë edhe rregullore mbi zgjedhjen e kështillit drejtues të shkollës, rregulloren mbi punën e kështillit drejtues të shkollave si dhe për nenet tjera që i përmende po ashtu mundesin e fuzionimit neni 57-58 edhe këto iu paraprinë përpilimit të rregulloreve tjer, neni 27-28 do të pasojnë do të procedojnë mënjeher rregulloren për procedurat dhe masat disiplinore edhe për personel arsimor por edhe për nxenes.

Haka Tahiraj- një punë qka mua më shqeteson mua është etika e veshjes, problem është se e drejtë e gjithkuj është qka dhe si veshet, por sa i përket arsimit duhet me pas më shumë kujdes si mesimdhënesi ashtu edhe nxënësi sa i përket kodit të veshjes, psh mesuesi i ed fizike vjen me trinerka, mirpo etika e veshjes duhet me qenë tek mesimdhënesit, ne e kemi pas rregullorene me heret dhe ka shumë pak ndryshime krahasuar me rregulloren që ka qenë më heret me sa e kam shikuar unë.

Bedri Nika- kjo rregullore nuk është njëra ndër rregulloret ma të mira të mundshme që mundet me qenë, gjitha diskutimet që janë nuk prekin në-bazen e kësaj rregullore, ne nga pika 1 deri ne pikën e 79 mundemi me gjet vërejtje të vogla të rregullores, por ajo qka dua të degjoj unë kështu është mendimi i komisionit që e kemi votar ne vet, a kanë punuar në atë rregullore dhe në rast se rregullorja ka ardh pa miratimit e komisionit atëher rregullorja të kthehet mbrapsht, megjithatë ne mund të kemi vërejtje për

shkolla për transportin e fëmijëve sepse nuk është adekuat nuk është i mirë sepse e ndër ngarkojnë kombin me fëmijë. Unë nuk e mbështes rregulloren pa e degju mendimin e komisionit që ne e kemi zgjedh.

Nexhmedin Balaj- para vetes e kemi draft rregulloren për punën e institucionit edukativo arsimor dhe këtu po i përdorni politikat e veta dhe inatet e veta pikërisht për me e sulmu gjendjen në arsimin të harrojmë se në krye të kësaj rregullore e kemi objektivin e kësaj rregullore ku thotë është krijimi dhe funksionimi efikas i procesit edukativo arsimor në Komunën e Drenasit për realizimin dhe synimin e kompetencave të saj të mbështetura e të përcaktuara në aktet ligjore dhe udhëzime administrative që janë në fuqi lidhur me arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, pra ne e kemi pas një bazë gjatë përpilimit të kësaj rregullore, edhe unë jam anetar i komisionit në përpilimin e kësaj rregullore.

Petrë Sinani- unë së pari kisha kërkuar nga komisioni paraprakisht një raport nga anetarët e komisionit me kundërshtimet që janë bërë sepse ne e kishim pas ma te lehtë pastaj me e votu për ose kunder, kërkesa në komision ka qenë që të futet kodi i veshjes në rregulloren e arsimit parauniversitar, neni 34.10 thotë veshja rregullohet sipas këtij udhëzimit 06/2014 mirëpo ne e kemi ngaterruar pak sepse nga ana ligjore thotë se nuk lejohet propagandimi fetar thotë decidivisht, nuk thotë askund që veshja ose kodi i veshjes është propagandim fetar keto dy gjera duhet me dit ne me i dallu. Kjo rregullore është punuar sipas mendimit tim në mënyrën ma të mirë të mundshme me përjashtim me ato gabime teknike që i cek kolegu ma heret z.Gashi.

Nexhmedin Balaj- ky tha që nuk jeni unik, ne që dy vjet e gjysme jemi duke punuar në këtë rregullore, e vetmja gjë që nuk jemi unik është të kodi i veshjes që është e përcaktuar me udhëzim administrative.

Florentina Elezi- e përgezoj Drejtorin e Arsimit për arsye se kam qenë edhe ne debat publik edhe ne K.P.F-ca e përgezoj drejtorin dhe shpresoj që nuk do të ndryshoj sepse ka pas një kulturë shumë të mirë të komunikimit dhe shpresoj se kemi me pas edhe shumë persona të tillë para nesh, ajo që nuk me ka pëlqy nga komisioni ka qenë qasja ndaj personave që kanë qenë dëgjim publik edhe pse kanë qenë pak ka qenë shumë e ashpër prej disave gjithashtu edhe për neve anëtarëve të K.P.F-ca të cilin ne kemi qenë debat publik për me marrë rekomandimet që me i adresu ne para kolegeve tanë por edhe me ditë që ka me bërë në K.P.F-ca kanë qenë sjellje teper agresive që mua nuk më kanë pëlqy aspak, dhe po e shpaloj këtu si vërejtje se me pas kujdes ne herave te tjera me pas shumë kujdes se kanë po e votojme ne për komisione, dhe në K.P.F-ca ne kemi kërkuar raport i cili nuk është sjellë as sot, për që keni pas kundërshtime që keni votu që jeni ardh deri te pajtimi ose mos pajtimi lidhur me këtë rregullore nuk kemi pas as në K.P.F-ca raport dhe nuk po e kemi as tani, i kam disa vërejtje psh te neni 17.1.6 janë ekipet mbështetëse profesionale a janë ndonjë shkollë të Drenasit apo a pritët me qenë sepse me sa e di unë nuk janë, dhe më pëlqyen shumë ekipi për parandalimin e dhunës, për braktisjen e shkollës dhe ekipi për parandalimin e dukurive negative, dhe të neni 18 sa i përket pushimit të gjatë unë kisha thënë që pushimi i gjatë 15 min është shumë i shkurter sepse nuk mundën me bë asgjë, të neni 34.10 ne jemi daltetu me i mbrojt te drejtat dhënë të mirë të qytetarëve dhe jo me u mundu me ia mohu te drejtat askujt, dhe me këtë gjë nuk pajtohem me koleget e asambleiste, edhe tek neni 39 vlersimi për lëndë është i vazhdueshem dhe ndërtohet gjatë semestrit me duket se duhet me qenë period sepse ndoshta është gabim teknik. Tek neni 39.4 dhe 39.5 kjo 39.5 ndoshta kish mjaftu me 39.4 ndoshta, gjithashtu edhe të neni 42 edhe unë kam qenë që me u shtu ora e kujdestarisë, dhe neni 66.6 gjoba është 50-100 € mendoj se duhet me qenë një shumë edhe me lartë por shpresoj se nuk ndodh kjo gjë në shkolla.

Vehbi Berisha - derisa po e lexoja këtë rregullore edhe unë vëreja tek neni 75 pika 2 u cek se organogrami i ankesës në vijim duhet të vendoset në hapsirën publike, ndoshta kishte qenë më mirë si formë organogrami më iu bashkangjit kësaj rregullore dhe meqense rregullohen pozitat e gjithë akterëve në arsimin në Komunën e Drenasit ndoshta kishte qenë më mirë me iu bashkangjit një organogram ku

tregohet përmes shigjetave niveli ipërgjithsive dhe raportimeve. Të pikat tjera i shikova ishin të sqaruara shumë mirë, dhe më gezoj fakti se nga kjo rregullore kanë më rrjedhë edhe disa rregullore tjera, unë personalisht jam kunder qdo dukuri që e pengon mesimdhënie dhe mësimnxenie në institucionet edukative arsimore në Komunën e Drenasit.

Z. Gani Podrimqaku- e hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës prezent gjatë votimit ishin 26 anetar:

Për votuan 22 anetar

02 abstenim

02 kunder.

Z. Gani Podrimqaku- hapi diskutimin për pikën e katër të rendit të ditës: **4. Raporti vjetor i punës së Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale për vitin 2019.**

Sokol Bylykbashi - do të doja që të flasim sot për projektet e kohës së përparume por më duhet të flas për projektet të prapambetura që në fakt janë shumë të domosdoshme, konkretisht dua me fol për dy kategori të investimeve kapitale, pra për kanalizim dhe ujesjellës për gjendjen në terën, kur e mendojmë termin civilizim mendja na shkon të diqka e lartë diqka e ngritur dhe nuk gabojm ashtu është por në fakt thelbi i civilizimit është diqka tjetër është posht është në tokë me saktësisht është nëntokë civilizimi ka fillu me metrat e para të kanalizimit pse për shkak se është pra qenia e vetme që ka turp nga jashtëqitja e tij, me qëllim e zbërtheva këtë term për më tregu rëndësin e kanalizimit pra jan 20 vite nga përfundimi i luftës ne i kemi lënë fshatrat e lagja të tëra pa kanalizim, pa civilizim, i kemi lënë me turp e në fakt ai është turpi jonë, unë mendoj që ky raport që e kemi këtu tani është dasht me qene raport i punës ku nevojat bazike të qytetarve siq është pra kanalizimi edhe ujesjellesi më na tregu përmes këti raporti që ka një progress te madh apo ka përfundu komplet, kanalizimi dhe ujesjellesi janë kategori kapitale të cilat duhet me u përfundu para investimeve tjera nese ka një listë të prioriteteve në investim mendoj që kanalizimi dhe ujesjellesi duhet me qenë jo asfalti sa i përketë ujsjellsit unë i kam shenu disa të dhëna që i kam marrë nga njësit e ndryshme të ujsjellsit rajonal, por nese e krahasojm me Lipjanin nuk ka rëndësi kush qevëris Drenasi dhe Lipjani nuk kan shumë dallim me numrin e banorëve, pra Lipjani ne ujsjelles i ka të kyqur 9800 konsumator ndërsa Drenasi 5200 është dasht edhe na me punu në mënyrë që me kyq sa me shumë familje në rrjetin e ujsjellsit për shkak se kemi burimin me sa di unë vjen prej liqenit të ujmanit dhe është dasht qe ne në këtë rrjet të jene të kyqur edhe me shum konsumator ,sepse kemi shumë familje në shumë fshatra që nuk kan uj të pijes. Propozimi im është që në draft buxhetin tjetër për vitin e ardhëshem ,buxhetin që ne e kemi ndarë për asfalt me përgjysmu dhe pjesa e mbetur me shku për kanalizim dhe ujsjelles në mënyr që t'i përfundojm këto dy problem që janë shumë të domosdoshme dhe kanë impact edhe në aspektin shëndetësor dhe jetsor. Probleme të tilla kan fshatrat Tërstenik Polluzh, Verboc, Shtutic etj.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci- faleminderit shumë për propozimet mirëpo kërkesat se qfarë projektesh me bërë në komunën e Drenasit i marr nga debatet me qytetar për nevojat e tyre kështy që unë i kam humb do poena, por me një grand që do ta marrë afër 3.000 euro nga niveli qëndror për performancë të mirë në momentin që të miratohet buxheti ato shkojn në plus sikurse kemi marr qindra mija euro, për performancë të mirë dhe të gjitha ato mjete i kam investu në kanalizim të ujrave të zeza, dhe në pastrim të lumenjeve tanë, mirë është me cek dhe me thënë që askush lumenjet tanë nuk i ka pastruar prej që e mbaj mend pleqt e tanë 40 km për tre muaj i kam bërë dhe për gjatë lumenjeve dërgoj kolektoret me të vetmin synim qe ujrata e zeza me i largu prej fushave tona, lumenjeve, prrockave kështu që unë me gjithë atë të falendëroj, por krahasimin që e bërë komunës se Drenasit me Lipjanit është i pa arsyeshëm sepse një herë duhet me ditë lipjani sa fshatra edhe sa banor i ka pas edhe para lufte në rrjet të ujsjellsit e dyta nuk e dini numrin e saktë të ekonomive familiar që janë të lidhur në rrjetin e ujsjellsit,

Kishnareka është po thuajse tërë fashti në rrjet që im ka bërë komuna para neve po asnjëri nuk ka pranuar edhe nuk ka hën në rrjet dhe kemi humb edhe donacion nëse nuk gabo për me ja dërgu orët me i lidh në rrjet mirëpo ata nuk kanë dashte se pse janë mësuar me shfrytëzuar ujin pa pages prandaj duhet me mirëmbajt edhe bazenat e ujit atje edhe në Krajkovë, sepse edhe kjo është në rrjet por nuk kanë uje astënjë sepse herë e bëjmë pronën private herë e bëjmë që është shpronësuar ose që është liri dikush në punë në baze të asaj për me dhënë ujin por pa i kompletu dokumentet nuk po them asgjë sot kush ka qënë në likoshan e ka pa rrjetin e ujesjellsit sekondarin gypat ende janë nëpër toke mbi toke pa i fut fare në tokë dhe askush nuk e din arsye po unë ka tri ditë që i kam kërku drejtorëve me komunikime kompaninë e ujesjellsit rajonal të Prishtinës dega në Drenas për me e fut në cc edhe Drejtorin e qendrës sepse shumë rrjetit të ujesjellsit na mungojn dhe nuk janë fare hiq në tokë, ose janë të dëmtuar dhe kjo e zvarrit rrjetin për disa fshatra të komunës tonë.

Sokol bylykbashi - nuk po dua me ju hy në hak shumë qytetarëve sepse nëpër shumë lagje që ata e kanë bërë me vetfinancim ose me participim kanalizimin edhe ujesjellin siç është rasti në lagjen time tek bylykbasht, pra qytetarët kanë kontribuar me aq sa kanë pasur mundësi. Sa i përket trajtimit të ujërave të zeza në kemi biseduar por unë këtë punën e ujeave të zeza e shohe më tri faza, faza e parë kur e hap kanalin e largon ujrat e zeza prej vendbanimit e deri të kolektorëve, faza e dytë janë kolektorët ata që i bartin ujërat e zeza faza e tretë dhe finale që kryhet procesi i ujërave të zeza janë impiantet, mirëpo sa i përket impianteve fabrikën për përpunimin e ujërave të zeza nuk kanë dëgjuar që është bërë ndonjë debat, kam dëgjuar se egziston një impiant dikur në Drenas, nuk idi kapacitetet nuk e di a është funksional kështu kam dëgjuar, puna e impianteve është punë e grandëve qeveritarë sepse ka kosto shumë të lartë 10 milion ose edhe më shumë varësisht nga kapaciteti dhe nevojave që i kemi, janë këto tri faza por ne jemi shumë larg. Në fazën e parë qytetarët kanë kontribuar, komuna ka punuar veçse ka defekte, ka ankësuar sidomos gropa septike dhe disa pjesë të kanalizimit s'janë përfunduar siç duhet, pra unë them t'i përfundojmë edhe këto.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci-Sokol i falenderoi fqinjët tuaj por edhe të gjithë banorët tjerë. Mirë që po i cek këto faza, mirëpo si e kërkon rregulli është që së pari të ndërtohet impianti e pastaj të vendosen kolektorët e pastaj me u lidhë me lagje.

Petrit Sinani- unë e kam bërë edhe një kërkesë edhe me heret, kam debatuar këtu që Komuna e Drenasit të marrëpërsipër sikurse ujesjellsin dhe berllugin t'i kthejë në kompani komunale do të ishte mirë që herave të tjera të fillojnë procedurat dhe kjo normalisht të përfshihet edhe në raporte punës, ndërsa sa i përket raportin nuk kam diqka për me diskutu.

Pasi nuk pati diskutime tjera z. Podrimqaku hapi diskutimin për pikën e 5 të rendit të ditës: **5. Propozim vendim për miratimin e Statutit të ri të QKMF-së Drenas.**

Pasi nuk pati diskutime, verejtje apo sugjerime z. Podrimqaku e hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, ku present gjatë votimit ishin 21 anëtar.

Për votuan 18 anëtar

Kunder nuk pati

Abstenim 03.

Z. Podrimqaku- hapi diskutimin për pikën e 6 të rendit të ditës: **6. Draft-Propozim për ndryshim-plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngastra dhe Gjoha 2020. E plotësuar.**

Pasi nuk pati diskutime, verejtje apo sugjerime z. Podrimqaku e hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, ku present gjatë votimit ishin 21 anëtar.

Për votuan 18 anëtar

Kunder votuan 03 anëtar

Abstenim nuk pati.

Z.Podrimqaku - hapi diskutimin për pikën e 7 të rendit të ditës: **7. Propozim Vendim për caktimin e qirasë joprofitabile për përfituesit e programit të veçantë të banimit.**

Pasi nuk pati diskutime, verejtje apo sugjerime z. Podrimqaku e hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, ku present gjatë votimit ishin 21 anetar.

Për votuan 21 anetar

Kunder nuk pati

Abstenim 03.

Z.Podrimqaku -hapi diskutimin për pikën e 8 të rendit të ditës: **8 . Të ndryshme.**

Petrît Sinani- unë po e paraqes një kërkesë që e kanë shumë biznese dhe shumë punonjes të këtyre bizneseve, po e shohum se shumicen e komunave ditën e diel të bëhet pushim për të gjitha bizneset, dhe po e dha si propozim që në seancën e radhës që të vie një propozim vendim në mënyrë që që ta bëjmë ditën e diel ditë pushimi për biznese, ligji e lejon këtë dhe është shumë mirë e përcaktuar edhe me ligj dhe me kërkesë të bizneseve për disa kategori të caktuara jo për të gjitha kategoritë e bizneseve. Po ashtu propozoj që inspektoriati i punës i Komunës së Drenasit të vazhdoj në inspekimin e punonjesve sepse po ka ankesa të ndryshme nuk po e respektojnë orarin e punës, po i mbajnë me orë të zgjatura.


Sokol Bylykbashi- edhe unë kërkoj dhe kam pas kërkesa nga puntoret dhe bizneset e ndryshme që dita e diel me qenë ditë pushimi. Por jo më ardh një propozim vendim këtu pa pas një takim me bizneset e Komunës së Drenasit.

Kryetari i Komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovc- unë sa herë që kam ankesa i përcjelli dhe i adresoj. Sa i përket ditës së diel me qenë ditë pushimi unë as nuk jam me ndal as me e lene ditë punë, caktone ju një komision dilni folni me biznese.


Adem Bucolli- edhe unë jam për me formu një komision dhe me dal më fol me biznese dhe disa biznese kanë kërkuar që ditën e diel me e bërë ditë pushimi edhe unë jam për me e mbeshtet këtë.

Pasi nuk pati më diskutime, verejtje apo sugjerime z. Podrimqaku e konsideroj si të mbyllur seancën e Kuvendit Komunal Drenas.

Seanca përfundoj rreth ores: 16:45 min.

Proccsmbajtese
per 
Liridona Fejza Ajazi



Presidenti i Kuvendit Komunal

Labinot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur me datë 20.03.2020, si vijon:

-Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj.

Pasi kryesuesi i mbledhjes përshëndeti të pranishmit njoftoi anëtarët e K. P .F-ca me rendin e ditës.

Fjalën ja kaloi Kryetarit të Komunës- Ramiz Lladrovci i cili shtoi dhe një pikë të rendit të ditës:

1. - Diskutim rreth situatës emergjente e krijuar nga COVID-19, dhe mundësit e ndarjes buxhetore për tejkalim të situatës në Komunën e Drenasit.

Kryesuesi i mbledhjes i ftoi anëtarët ta votonin rendin e ditës:

U

Miratua me **07 vota Për, Kundër: 00, dhe abstënim: 00**

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj kalojmë te pika e parë.

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 21.02.2020.

Spat diskutime - Votuan 07,vota për, Kundër: 00, dhe abstënim: 00

2. Propozim Vendim i statutit për ndërmarrjen publike Lokale "Stacioni i autobusëve", SH. A. në Drenas-Glllogoc.

Edhe kjo pikë e rendit të ditës kaloi me; **07 vota për, 00 kundër, 00 abstënim**

3. Propozim Vendim për formimin e komisionit për vlerësimin e pronave që mund të këmbëhen dhe dhënien e rekomandimeve për pronat që duhet të shpronësohen në parcelën 743/1,në zonën e kadastrave Drenas.

- **Kjo pikë e rendit të ditës u votua si; 07 vota për, 00 kundër dhe 00 abstënim.**

4. Diskutim rreth situatës emergjente e krijuar nga COVID-19, dhe mundësit e ndarjes buxhetore për tejkalim të situatës në Komunën e Drenasit.

Kjo pikë e rendit të ditës u rekomandua të kalojë për Kuvend.

5. Të ndryshme.

Pasi spati diskutime mbledhja përfundoi në ora 11:08



Kryesuesi i Kuvendit
Labinot Halilaj



Republik e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIC OF KOSOVO			
MUNICIPALITY OF GLOGOC			
GLOGOC MUNICIPALITY			
DATE	12.03		2020
NO.	030-	13578	



Komuna e Glogocit
Opstina Glogovac
Municipality of Glogoc
Zyra e Kryetarit

Datë: 12/03/2020

<http://kk.rks-gov.net/glogoc/>

PROPOZIM VENDIM

STATUTI

PËR

NDËRMARRJEN PUBLIKE LOKALE “STACIONI I AUTOBUSAVE ”

SH.A. NË GLLOGOC

MARS / 2020

Mbështetur në nenin 34 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare në Kosovë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" 9/2018, 24 maj 2018), të dispozitave të nenit 4, paragrafët 4.1 dhe 4.2 të Ligjit Nr.03/L-087, për ndërmarrjet publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", 1/2008, 15 qershor 2008). Ligji Nr. 05/L -009 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe i plotësuar më ligjin 04/l-111 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" 10/2015, 07 maj 2015, neni 12 paragrafi 1, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", 28/2008, 04 qershor 2008), neni 72, pika 72.2 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës së Gllogocit të miraton këtë:

STATUTI

PËR

NDËRMARRJEN PUBLIKE LOKALE "STACIONI I AUTOBUSAVE "

SH.A. NË GLLOGOC

1. Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

1. Me këtë Statut rregullohen parimet themelore si, emërtimi, selia, veprimtaria e Ndërmarrjes Publike Lokale " Stacioni i Autobusëve" SH.A. në Gllogoc, statusi juridik, përfaqësimi-prezantimi, strukturat dhe trupat organizative të institucionit public, zhvillimi I vazhdueshëm profesional, aktet e përgjithshme, pronësia dhe financimi, transparenca, konfidenca afariste dhe profesionale, mbikëqyrja e brendshme, dispozitat kalimtare dhe përfundimtare lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së Ndërmarrjes Publike Lokale"Stacioni i Autobusëve " SH.A. në Gllogoc (në tekstin e mëtejme: "Statcioni i Autobusëve" SH.A. Gllogoc).

2.Ndërmarrja publike lokale "Stacioni i Autobusëve" SH.A. në Gllogoc, ka statusin e ndërmarrjes publike lokale, e cila mund të paditet dhe të padisë, të posedojë të udhëheq dhe t'i përcaktojë kushtet e udhëheqjes dhe shfrytëzimit të pasurisë së saj, të lidhë kontrata, të punësoj dhe të largojë punonjës nga ndërmarrja dhe të angazhohet në aktivitete të tjera, të cilat janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësisë së saj nëse nuk është e rregulluar ndryshe me ligj dhe akte nënligjore.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Ndërmarrja publike lokale “Stacioni i Autobusëve” SH.A. në Glllogoc, ka hapsirë për pranimin dhe përcjelljen e autobusëve sipas rendit të udhëtimit, hyrjen dhe zbritjen e udhëtarëve, shitjen dhe rezervimin e biletave për udhëtarë, gardërobën, paisjen për informimin e udhëtarëve dhe operatorëve të transportit, si dhe shërbimet tjera që kanë të bëjnë me transportin e udhëtarëve dhe operatorët transportues.
2. Ndërmarrja publike lokale “Stacioni i Autobusëve” SH.A. në Glllogoc është i obliguar që të mbajë evidence për hyrjen dhe daljen e autobusëve të sektorit publik dhe të sektorit privat.
3. Me fuqizimin e rendit të udhëtimit, Ndërmarrja publike lokale “Stacioni i Autobusëve” SH.A. në Glllogoc është i obliguar të bëjë sistematizimin e rendit të udhëtimeve sipas realicioneve dhe kohën e nisjes së autobusëve nga sistemi.
4. Ndërmarrja publike lokale “Stacioni i Autobusëve” SH.A. në Glllogoc në kushte të barabarta, t’u ofron shërbime të gjithë operatorëve transportues, të cilët e kanë rendin e udhëtimit të regjistruar dhe vërtetuar në Komunën e Glllogocit, sipas tarifës së përcaktuar nga Komuna e Glllogocit, bazuar në kategorinë e stacionit të autobusëve.
5. Ndërmarrja mund të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar, i cili lidhet direct apo indirect me objektin e saj, Brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
6. Ndërmarrja dë të kryejë çdo veprim, me qëllim të marrjes së lejeve, autorizimeve, licencave dhe miratimeve të nevojshme për realizimin e veprmtarisë së saj, për të cilat kërkohen këto dokumente administrative.

Neni 3

Selia qendrore

1. Selia kryesore Ndërmarrja publike lokale “Stacioni i Autobusëve” SH.A. , Rr.”Ilaz Kodra” pa.nr. në Glllogoc.
2. Shenja njohëse (emblema) e NPL-së do të dizajnohet nga Bordi i Drejtorëve i ndërmarrjes dhe do të miratohet nga ky Bord i Drejtorëve.
3. Emërtimi i NPL-së duhet të jetë i mbishkruar në objektin kryesor të NPL-së në të cilën kryhet veprimtaria publike dhe atë në gjuhët zyrtare në përdorim në Republikën e Kosovës.
4. Për ndryshimin e emrit dhe selisë së NPL-së, vendosë thmeluesi.

Neni 4

Përfaqësitë e Ndërmarrjes-shoqërisë aksionare

Ndërmarrja/shoqëria aksionare, sipas këtij statuti dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, mund të hapë: qendra, përfaqësi apo degë duke zhvilluar aktivitetin e vet branda Komunës së Glllogocit.

Neni 5

Kohëzgjatja

- 1.Kohëzgjatja e ndërmarrjes publike lokale “Stacioni i Autobusëve” SH.A. në Glllogoc si shoqëri aksionare, është e pakufizuar, përveç nëse vendoset ndryshe me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe aktet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
- 2.Nëse kohëzgjatja e ndërmarrjes ndryshohet. Për këtë duhet të njoftohet Agjencia për Regjistrimin e Biznesit në Republikën e Kosovës dhe të kërkohet që kjo të publikohet nga ana e Agjencisë në bazën e të dhënave të saj.

Neni 6

Themeluesi i Ndërmarrjes

- 1.Komuna e Glllogocit është pronare e ndërmarrjes, me aksione 100% në pronësinë e saj.
2. Ndërmarrja publike lokale “Stacioni i Autobusëve” SH.A. në Glllogoc, është trashëgimtare e ndërmarrjes shoqërore N.P.T.SH. “KosovaTrans” në Glllogoc.
- 3.”Stacioni i Autobusëve” SH.A. në Glllogoc, themelohet pas regjistrimit të Statutit në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Republikën e Kosovës, sipas dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare në Kosovë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” 9/2018, 24 maj 2018).

Neni 7

Statuti dhe Rregulloret

- 1.Ndërmarrja themelohet vetëm pas regjistrimit të këtij Statuti në Zyrën e Regjistrimit të Biznesit. Ky Statut është dokumenti themelues dhe konstituiv i Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” në Glllogoc. Ndryshimet dhe Plotësimet në statut, nuk kanë efekt juridik derisa të miratohen nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L. “Stacioni i Autobusëve” SH.A. në Glllogoc dhe nga Kuvendi Komunal i Glllogocit dhe të dorëzohen në Zyrën e Regjistrimit të Biznesit në përputhje me dispozitat ligjore.
- 2.Ndërmarrja, obligohet të nxjerrë rregulloret të cilat përmbajnë dispozita për administrimin dhe funksionimin e saj, Rregulloret miratohen, ndryshohen ose revokohen nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L. “Stacioni i Autobusëve” në Glllogoc.

Neni 8

Përgjegjësitë

- 1.Komisioni komunal i Aksionareve, Bordi i drejtorëve dhe stafi i “Stacionit të Autobusëve” SH.A. në Glllogoc, është përgjegjëse për pasurinë që e gëzon ajo, të drejtat dhe detyrimet që vijnë si rezultat i këtij transformimi.
- 2.Asnjë person, shoqëri tregtare ose shoqëri tjetër, nuk është përgjegjëse për detyrimet e shoqërisë aksionare vetëm për shkak se është kontraktues në këtë shoqëri.

Neni 9
Mbikëqyrja Administrative dhe Menaxheriale

Ndërmarrja Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” SH.A. në Glllogoc mbikëqyret nga Bordi i Drejtorëve dhe menaxhohet nga Kryeshefi Ekzekutiv.

Neni 10
Përgjegjësitë e themeluesëve për veprimet para regjistrimit

Nëse janë ndërmarrë veprime në emër të ish-ndërmarrjes para regjistrimit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në hapjen e xhirologarive bankare, blerjen dhe dhënien me qira të pronës, lidhjen e kontratave ose ndërmarrjen e detyrimeve të tjera, pasi Shoqëria të jetë regjistruar, ajo e merr përsipër përgjegjësinë për këto detyrime dhe raste të tilla, “Stacioni i Autobusëve” SH.A. në Glllogoc. Është e vetmja pale përgjegjëse për pretendimet dhe detyrimet.

Neni 11
Shpallja e tarifave

1.Statuti, aktet normative të ndërmarrjes dhe tarifat për dhënien e shërbimeve të N.P.L. “Stacioni i Autobusëve” SH.A. në Glllogoc publikohen në tabelën e publikimit të ndërmarrjes.

22.Ndërmarrja me rastin e aprovimit të tarifave të reja është e obliguar të njoftoj shfrytëzuesit nëpër mes shpalljeve në tabelën e shpalljeve të ndërmarrjes, në ndënjë vend adekuat në “Stacion të Autobusëve” dhe nëse ka mundësi finciare edhe nëpërmes të informimit publik.

Neni 12
Kapitali

Kapitai themeltar i ndërmarrjes përbehet nga pasuaria e luajtshme dhe e paluajtshme. Aksionari I vetëm i ndërmarrjes është Komuna e Glllogocit. Të gjitha ndryshimet e kapitalit themeltar, bëhen sipas përcaktimit në ligjin Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, ku përfshihet shuma, parapagimi, rritja e kapitalit themeltar, zvogëlimi i kapitalit themeltar, etj.

Neni 13
Mbledhja e Aksionarëve

1.Mbledhja e aksionarëve të “Stacioni i Autobusëve” SH.A. në Glllogoc, është organi më i lartë vendimmarrës i ndërmarrjes publike lokale.

2.Vendimet e mbledhjes së aksionarëve janë detyruese për ndërmarrjen, Bordin e Drejtorëve të ndërmarrjes, si dhe për zyrtarët e ndërmarrjes.

3.Thirrja dhe rendi i ditës së mbledhjes, njoftimi i mbledhjes dhe procedimet, kourumi për mbledhje, udhëheqësi i mbledhjes, votat e aksionarëve dhe kompetencat e mbledhjes do të rregullohen me akte të veçanta, në pajtim me nenin 130 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare në Kosovë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" 9/2018, 24 maj 2018).

Neni 14 **Bordi i Drejtorëve**

1.Bordi i Drejtorëve të N.P.L. "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. do të përbëhet nga pesë (5) drejtor.
2.Katër (4) drejtor zgjidhen në një mbledhje të Komisionit Komunal të Aksionarëve në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare në Kosovë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" 9/2018, 24 maj 2018). Mandati i tyre është prej 3 viteve. Komisioni Komunal i Aksionarëve e përfaqëson Komunën në këtë mbledhje dhe i ushtron të drejtat e votimit të komunës në përputhje me këtë ligj. Drejtori tjetër është Kryeshefi Ekzekutiv (KE) i Ndërmarrjes Publike I cili zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike në përputhje me nenin 21 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

3.Bordi i Drejtorëve është organ i pavarur edhe nga dërmarrja.

4.Menaxheri ose Zyrtari i Ndërmarrjes nuk mund të jetë Antëtar I Bordit të Drejtorëve.

Neni 15 **Funksionimi i Bordit të Drejtorëve**

Kompetencat dhe përgjegjësit e ndërmarrjes publike locale, "Stacioni i Autobusëve" SH.A. në Gillogoc, do të ushtrohen nga Bordi i Drejtorëve, ashtu siç është përcaktuar me ligj, statutin e "Stacionit të Autobusëve" SH.A. në Gillogoc dhe nga aktet të cilat vetë i ka miratuar.

Neni 16 **Përgjegjësit dhe detyrat e Bordit të Drejtorëve**

1.Të respektojë ligjet, statutin e ndërmarrjes, aktet e tjera dhe të zbatojë vendimet e Komisionit Komunal të Aksionarëve, në pajtushmëri me ligjin.

2.Të përcaktojë, dhe së paku çdo 3 (tre) muaj të rishikoj strategjinë e ndërmarrjes.

3.Të përgatisë dhe të miratojë strategjinë afatmesme apo afatgjatë, investimet dhe planet financiare të ndërmarrjes dhe brenda afatit relevant kohor, të rishikojë atë kurdo që është e nevojshme, së paku në çdo 3 (tre) muaj të bëjë ndryshime, të cilat mund të jenë të nevojshme.

4.Të miratojë planin vjetor të biznesit dhe buxhetin vjetor, të përgaditur nga Kryeshefi Ekzekutiv , në bazë të planit afatmesëm apo afatgjatë.

5.Të emëroj, largojë apo zëvendësojë Kryshefin Ekzekutiv, të përcaktojë me propozim të Komisionit të auditimit kompensimin e tij ose saj, dhe të sigurojë që procesi për përzgjedhjen e

KE-së do të organizohet në mënyrë transparente dhe të arsyeshme, në këtë mënyrë t'i sigurojë shoqërisë disponueshmërinë e talenteve dhe kompetencave adekuate.

6.Të përcaktoj rastet, përkatësisht çështjet dhe transaksionet, të cilat nuk janë në kompetence të KE-së, përkatësisht ka fuqi të kufizuar për të vepruar në mënyrë të pavarur në kuptim të dispozitave të nenit 192 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

7.Të emërojë dhe largojë ZKFTH dhe sekretarin e përgjithshëm, dhe në bazë të propozimit të Komisionit të auditimit të përcaktojë kompensimin e tyre.

8.Të përcaktojë, me propozim të KE-së, transaksionet financiare, në bazë të cilave KE-ja nuk do të ketë fuqinë të veprë (dhe të obligojë ndërmarrjen) në mënyrë të pavarur, dhe do të duhej të kërkojë autorizim paraprak nga KE-ja, apo nga Bordi i Drejtorëve.

9.Të kryejë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigorozë mbi punën e biznesit të ndërmarrjes mbi punën e KE-së, ZKFTH-së dhe sekretarit të përgjithshëm, mbi organizimin e brendshëm të ndërmarrjes dhe bi performance e ndërmarrjes, dhe të sigurojë se linjat e raportimit të ndërmarrjes janë të organizuar për të lejuar performance dhe mbi këto baza, të zbatojë këto detyra të besuara të zyrtarëve (në rastin e zyrtarit të auditimit të brendshëm, vetëm me propozim të Komisionit të Auditimit).

10.Të miratojë në fund të secilit vit të biznesit, pa kurrfarë vonese dhe në çfarëdo rasti brenda nëntëdhjetë (90) ditëve pas përfundimit të vitit financiar të ndërmarrjes.

11.Bilancin vjetor dhe pasqyrën e fitimit dhe humbjeve të ndërmarrjes, dhe çfarëdo pasqyre tjetër financiare që kërkohet me ligj.

12.Raportin vjetor të menaxhimit, rregulloret e biznesit, gjendjen financiare të ndërmarrjes do të duhet të përfshijë vështirësitë, në atë mënyrë që performance e ndërmarrjes të mund të barazohej me planet afatmesme apo afatgjata dhe të paraqesë propozimin e saj për alokim, investim apo shpërndarje të fitimit vjetor, apo mulimin e humbjeve.

13.Deklaratën për aksionarët që sipas njohurive më të mira të Bordit të Drejtorëve, duke marrë parasysh raportin e Komisionit të auditimit dhe sipas hetimit të vetë të pavarur dhe të kujdeshëm dhe konsolidimit adekuat, dokumentet e lartpërmendura janë të vërteta, të drejta dhe të sakta, dhe ato nuk lënë pa përmendur asnjë informatë apo pasqyrë e që mos përfshirja e tyre do të konsiderohej si lajthitje, dhe ato t'i dorëzojë, së bashku me raportin nga Auditori i Jashtëm në dokumentet e parashtruara tek aksionarët së paku tridhjetë (30) ditë para dates së mbledhjes së Komisionit Komunal të Aksionarëve.

14.Të sigurojë që sistemet adekuate të kontrollit të brendshëm, duke përfshirë kontrollin financiar dhe procedurat dhe proceduar janë në vendin e duhur.

15.Të sigurojë se sistemet dhe procedurat adekuate janë në vendin e duhur për të garantuar se librat dhe regjistrat e ndërmarrjes, duke përfshirë regjistrat financiarë, mbahen në pajtueshmëri me standardet e kontabilitetit dhe ligjeve në fuqi, dhe propozim raportet financiare vjetore janë të përgatitura si duhet.

16.Të sigurojë se auditimi i librave dhe regjistrave kryhet të paktën çdo vit nga Auditori i Jashtëm.

17.Të sigurojë se sistemet dhe procedurat adekuate janë vendosur për të garantuar se ndërmarrja i respekton të gjitha ligjet në zbatim gjatë kyerjes së detyrave.

18.Të identifikojë, me kërkesë të KE-së, shenjat adekuate, në mënyrë që të matet rregullisht performance e ndërmarrjes publike locale.

19.Të sigurojë se veprimtaria e ndërmarrjes nuk devijon nga qëllimi që parashihet sipas Statutit pa autorizimin e qartë të Komisionit Komunal të Aksionarëve.

20.Bordi i Drejtorëve mund të udhëzojë KE-në në organizimin e brendshëm të ndërmarrjes dhe alokimin e fuqisë dhe autoritetin vendim-marrës së bashku me zyrtarët e ndërmarrjes, dhe me

propozim të KE-së mund të caktojë zyrtarë të tjerë (përveç KE-së, ZKFTH-së, sekretarit të përgjithshëm dhe zyrtari për auditim të brendshëm), duke vendosur detyrat dhe rregullat e tyre në lidhje me emërimin, kompensimin, largimin apo zëvendësimin e tyre.

Neni 17 **Mbledhjet**

1. Bordi i Drejtorëve duhet të mbledhet në vendin e caktuar sipas njoftimit me shkrim për mbledhje, në zyrën e regjistruar të ndërmarrjes apo diku tjetër, kurdo që paraqitet nevoja nga ana e kryesuesit apo nga dy (2) e më shumë drejtorë.
2. Njoftimi për mbledhjen duhet të ketë rendin e ditës dhe duhet të dorëzohet me dorë apo email së paku tri ditë para mbledhjes.
3. Në rast të emergjencës, njoftimi për mbledhjen duhet të përcillet me shkrim dhe të dorëzohet me dorë apo email së paku një ditë para mbledhjes.
4. Në mbledhje, kryesuesi i Bordit të Drejtorëve, duke vepruar arsyeshëm dhe në pajtueshmëri me ligjin dhe këtë statut, duhet të përcaktojë prezencën e kuorumit, të drejtoj debatin, të mbajë procesverbalin, dhe të përcaktojë dhe deklarojë rezultatet e votimit.
5. Sekretari i përgjithshëm do t'i asistoj kryesuesit, përveç nëse çështja e konfidencialitetit kërkon që drejtori të veproj si sekretar i mbledhjes.
6. Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve janë të rregullta dhe valide, me prezencën e shumicës së drejtorëve dhe votimin e shumicës së drejtorëve pjesëmarrës në mbledhje.
7. Drejtorët të cilët mund të abstenojnë nga votimi dhe drejtorët të cilët kanë paraqitur konflikt interesash nuk do të përfshihen në numrim. Në rast barazimi me vota, kryesuesi i Bordit të Drejtorëve duhet të ketë votën vendimtare.
8. Kryesuesi i mbledhjes duhet të jetë në gjendje të përcaktojë identitetin dhe të drejtën e pjesëmarrjes së atyre që janë të pranishëm, të udhëhojë mbledhjen, dhe të konstatojë dhe deklarojë rezultatet e votimit.
9. Sekretari i përgjithshëm i mbledhjes duhet të jetë në gjendje të përceptojë ngjarjet në mënyrë adekuate gjatë mbledhjes.
10. Pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në diskutime dhe të votojnë për pikat e rendit të ditës, e gjithashtu edhe të lexojnë, të pranojnë apo të dërgojnë dokumentet që ndërlidhen aty (nëse ka).
11. Vendimi me shkrim i nënshkruar nga shumica e drejtorëve në zyrë, do të ketë të njëjtën fuqi dhe efekt sikurse vendimi që ka kauar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve, që është thirrur dhe mbajtur. Çfarëdo vendimi i tillë mund të përbëhet prej disa dokumenteve që kanë formë dhe përmbajtje identike, secili i nënshkruar nga një apo më shumë drejtor.

Neni 18 **Zyrtarët e Ndërmarrjes**

1. Zyrtarët e ndërmarrjes do të jenë: Kryeshefi Ekzekutiv, Zyrtari Kryesor Financiar, Zyrtari i Auditimit të Brendshëm, Sekretari dhe zyrtarët e tjerë të caktuar nga Bordi i Drejtorëve.

2.Kriteret për përzgjedhjen e Zyrtarëve të Ndërmarrjes do të përcaktohen duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Neni 19

Kryeshefi Ekzekutiv

1.Kryeshefi Ekzekutiv (KE) i Ndërmarrjes do të ketë autoritet për të lidhur kontratë, në pajtueshmëri me ligjin, statutin dhe aktet e tjera nënligjore, duke iu nënshtuar vetëm kufizimeve të përcaktuara nga Bordi i Drejtorëve.

2.Biznesi, detyrat dhe organizimi i ndërmarrjes duhet të kryhet sipas direktivave, mbikëqyrjes dhe përgjegjësisë së KE, në pajtueshmëri me statutin dhe aktet ligjore të ndërmarrjes dhe vendimeve të Bordit të Drejtorëve. Të gjitha çështjet në lidhje me biznesin e ndërmarrjes të cilat nuk janë përgjegjësi të Bordit të Drejtorëve, Komisionit të Auditimit apo Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm, do të vendosen nga apo sipas direktivave dhe përgjegjësisë të KE-së.

3.KE do të ketë autoritet të punësojë apo të largoj nga puna stafin e ndërmarrjes, përveç atyre që janë në kompetence ekskluzive të Bordit të Drejtorëve, për të cilët ka të drejtën e propozimit për punësim apo largim. Të drejtën e punësimit apo largimit të stafit KE mund ta delegoj edhe tek zyrtarët e tjerë përfshirë edhe :

3.1.Zyrtari Kryesor Financiar

3.2.Sekretarit edhe

3.3.Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm.

4.KE gjithashtu duhet të:

4.1.Këshillon dhe asiston Bordin e Drejtorëve në përcaktimin e strategjisë së ndërmarrjes si dhe planet strategjike afatgjate.

4.2.Dorëzon, sipas përgjegjësisë të tij Bordit të Drejtorëve, drafte të dokumenteve që parashikohen sipas ligjit për ndërmarrje publike.

4.3.T'i ofrojë kurdo që është e nevojshme, dhe së paku një herë në tre muaj, Bordit të Drejtorëve raporte për transaksonet kryesore të ndërmarrja nga ndërmarrja dhe për vendimet kryesore të ndërmarrja nga menaxhmenti në lidhje me udhëheqjen e biznesit dhe të punëve të Ndërmarrjes.

4.4.T'i dorëzoj nën përgjegjësin e tij/saj, Bordit të Drejtorëve dokumente, letra dhe informacione në lidhje me të gjitha çështjet e përfshira në agjendën e mbledhjeve të tij/saj.

5.T'i propozojë Bordit të Drejtorëve kritere adekuate për matjen e performances së ndërmarrjes si dhe t'i ofroj bordit rregullisht, por më së paku çdo tre muaj raportet e matjes së performances së ndërmarrjes kundrejt kritereve të tilla:

5.1.Të themeloj dhe rishikoj hierarkin dhe strukturën organizative të ndërmarrjes.

5.2.T'i ofroj Komisionit të Auditimit të gjitha informatat dhe asistencën që mund të kërkohej.

5.3.T'i ofroj Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm të gjitha informatat dhe asistencën që

mund të i kërkohej nga ky i fundit, si dhe
5.4. Të marrë pjesë në të gjitha Mbledhjet e Përgjithshme.

Neni 20

Zyrtari Kryesor Financiar

1. Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) i Ndërmarrjes do të menaxhojë nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e KE, çështjet financiare të ndërmarrjes, varësisht prej kufizimeve të vëna nga Bordi i Drejtorëve. ZKF do të ketë autoritetin e propozimit për lidhjen e të gjitha kontratave financiare për ndërmarrjen dhe do të jetë përgjegjës që:

- 1.1. Të mbajë llogaritë e ndërmarrjes të përditësuara dhe të sakta.
- 1.2. Të themelojë dhe udhëheq të gjitha kontrollet e brendshme financiare, duke përfshirë blerjet, pranimet e parave të gatshme dhe pasurit themelore, të monitorojë llogaritë e pagueshme dhe të koordinojë pagesën e faturave dhe blerjet special, të rishikojë shpenzimet e të punësuarëve për të siguruar pajtushmerinë me politikat e ndërmarrjes dhe buxhetin para pagesës së tyre.
- 1.3. Të përgadisë të dhënat e ndërmarrjes për auditim në fund të vitit.
- 1.4. Të koordinojë funksionet e tjera të biznesit, siç janë dhënia me qira e objekteve dhe paisjeve si dhe të bëjë blerje me KE dhe njësinë e prokurorimit të ndërmarrjes.
- 1.5. Menaxhoj thesarin e ndërmarrjes.
- 1.6. Të hartoj dhe propozoj buxhetet dhe
- 1.7. Çfarëdo tjetër detyre e përcaktuar nga ana e KE.

Neni 21

Zyrtari i Auditimit të Brendshëm

1. Nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e Komisionit të Auditimit dhe duke i raportuar ekskluzivisht atij, Zyrtari i Auditimit të Brendshëm të Ndërmarrjes do të jetë përgjegjës për:

- 1.1. Udhëheqjen, menaxhimin dhe organizimin e brendshëm të Zyrës së Auditimit.
- 1.2. Udhëheq dhe drejton të gjitha aktivitetet e auditimit të brendshëm dhe
- 1.3. Përbush çfarëdo detyre tjetër të përcaktuar nga ana e Komisionit të Auditimit.

Neni 22

Sekretari

1. Sekretari i Ndërmarrjes vepron si më poshtë:

- 1.1. Mirëmban regjistrin e të dhënave të ndërmarrjes.
- 1.2. Vepron si agjentë i ndërmarrjes për pranimin e njoftimeve.
- 1.3. Kryen të gjitha arkivimet, publikimet për autoritetet përkatëse siç kërkohej me ligj ose sipas këtij Statuti.
- 1.4. Mbikqyrë mirmbajtjen e duhur dhe përditësimin e rreullt të web-faqes të ndërmarrjes.

- 1.5.Koordinon me KE përgaditjen e dokumenteve për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve.
- 1.6.Menaxhon dokumentet, kontratat e punëtorëve, përshkrimin e vendeve të punës dhe përfaqëson Ndërmarrjen në kontestet gjyqësore dhe të tjera.
- 2.Sekretari do të mbaj procesverbalin e secilës mbledhje të Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit nëse nuk kërkohet ndryshe nga kryesuesi i tyre, dhe do t'i shënoj ato në librin e portokollit.

Neni 23 **Detyrat e besuara**

1.Çdo Drejtor i Bordit dhe Zyrtar të Ndërmarrjes publike do të kenë detyra të lëna në mirëbesim për ndërmarrjen, në përputhje me ligjin. Këto detyra në mirëbesim gjithmonë do përfshijnë detyrat që të:

- 1.1.Veprojnë në besim të mire ekskluzivisht për përfitime kolektive dhe për përfitime objektive të ndërmarrjes, gjithmonë në përputhje me ligjin dhe këtë Statut.
- 1.2.Të ushtroj fuqinë që iu është dhënë atyre ekskluzivisht në përputhje me interes më të mira kolektive.
- 1.3.Të ketë konsiderate adekuate për çështjet që duhet vendosur nga ata dhe të sigurojnë të gjitha informatat e nevojshme për marrjen e vendimeve të tilla, duke pasur parasysh ndërlikueshmërinë e tyre.
- 1.4.Të shmang dhe shpalos konfliktet e tanishme dhe potenciale në mes të interesave të tyre personale (direkte apo indirekte) dhe të interesave të Ndërmarrjes.
- 1.5.Të ushtrojë kujdes të arsyeshëm, zell dhe aftësi gjatë përmbushjes së funksioneve të tyre.
- 1.6.Të trajtoj si konfidenciale të gjitha informatat të pranuar me arsye nga zyra e tyre ose gjatë zbatimit të detyrave të tyre.

Neni 24 **Veprimet e Bordit të Drejtorëve pa mbajtjen e mbledhjes**

- 1.Përveç nëse me statut ose rregullore të ndërmarrjes kërkohet që një aktivitet i Bordit të Drejtorëve të ndërmerret ekskluzivisht në mbledhje të bordit, të gjitha aktivitetet të cilat mund të ndërmerren në mbledhjet e bordit, mund të ndërmerren edhe pa mbajtjen e mbledhjes nëse me pëlqim me shkrim, që përmban edhe natyrën e aktivitetit përkatës, nënshkruhet nga të gjithë drejtorët me të drejtë vote për atë çështje.
- 2.Të gjitha këto pëlqime duhet të përmbahen në një ose më shumë miratime me shkrim, të cilat duhet të paraqesin aktivitetin e ndërmarr si dhe të kenë nënshkrimin e një ose më shumë drejtorëve.
- 3.Të gjitha këto pëlqime duhet të vendosen në procesverbalin nga mbledhja e Bordit të Drejtorëve të ndërmarrjes. Pëlqimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga të gjithë drejtorët, përveç nëse është caktuar një date tjetër e hyrjes në fuqi.

Neni 25

Komisionet e Bordit

1. Bordi i Drejtorëve, me rregulloren e tij të brendshme, përcakton kur mund të miratojnë themelimin e një ose më shumë komisioneve (komisioni për auditim ose për shqyrtimin e kompensimeve), që do të shqyrtojë, hulumtojë, rekomandojë ose të marrë masa të tjera jo obligative e që janë në kuadër të kompetencës së bordit.

2. Komisionet, mund të përfshijnë edhe anëtarët e bordit të drejtorëve edhe punëtorët e ndërmarrjes si dhe persona jashtë kompanisë, sipas përcakimit në rregullore.

3. Miratimi i rregulloreve për marrjen e vendimeve të bordit kërkojnë një numër më të madh të presences, shumica e anëtarëve të komisionit e përbëjnë kourumin dhe shumica e kourumit është e nevojshme për çdo rekomandim ose veprim tjetër të komisionit. Të gjitha vendimet dhe veprimet e tjera të komisionit i nënshtrohen rishikimit, ndryshimit dhe miratimit me jo më pak se 2/3 e anëtarëve të bordit.

Neni 26

Raporti i Bordit të Drejtorëve

Pas çdo takimi të Bordit të Drejtorëve, duhet të hartoj një raport të shkurtë në një gjuhë të qartë, duke vënë në pah një përmendje të vendimeve më të rëndësishme dhe rezolutave të arritura në mbledhje, duke i fshehur vetëm ato informata në lidhje me të cilat nevojitet konfidencialiteti i arsyeshëm. Informata të tilla do të përfshihen në raportet e mëvonshme kur më nuk ekziston nevoja për të ruajtur konfidencialitetin.

Neni 27

Konflikti i Interesit

1. Drejtorët dhe zyrtarët e një NP nuk mund të hyjnë në marrëveshje me atë të NP, përveç nëse ajo marrëveshje së pari miratohet nga aksionarët. Ky kufizim nuk aplikohet për kontratat e punësimit të zyrtarëve, për të cilat kërkohet vetëm miratimi i Bordit të Drejtorëve.

2. Drejtorët dhe zyrtarët e NP-së do të zbulojnë plotësisht me shkrim para Bordit të Drejtorëve të NP-së, çfarëdo interesa personale të çfarëdo natyre të cilat mund t'i kenë në lidhje me një aksion ose vendim afarist i cili do të merret nga NP në veçanti ata duhet që gjithmonë të zbulojnë interes financiar të cilat mund t'i kenë me konkurruesit afarist, kreditorët, furnizuesit e mallrave ose shërbimeve ose konsumatorët afarist të NP-së.

3.Zbulimi i konfliktit të interesave i lartë cekur në paragrafin 2 të nenit 27, duhet të bëhet nga çdo individ në kohën kur çështja përkatëse shfaqet ose në kohën kur individi merr pozitën përkatëse në NP.

Neni 28

Transaksionet me palët e ndërlidhura

1.Komisioni i Auditimit, rregullisht së paku çdo tre muaj do të lëshoj një raport të shkrutë dhe me një gjuhë të qartë, duke nxjerrë në pah transaksionet më të rëndësishme me palët e ndërlidhura të cilat nuk i ka miratuar, duke dhënë arsyet për mos-miratimin e tyre, dhe të gjitha transaksionet me palët e ndërlidhura që i ka miratuar duke paraqitur vlerën e transaksioneve.

2.Vlera e bilanceve të paguara, duke përfshirë kushtet, konditat dhe garancitë, provizionet për borxhet e dyshimta lidhur me vlerën e bilanceve të papaguara, dhe shpenzimet e paparanuara gjatë periudhës në lidhje me borxhet e këqija (të papaguara) apo të dyshimta të caktuara nga palët përkatëse si dhe deklaratat se kjo e fundit ka qenë e arsyeshme dhe e drejtë për shoqërinë.

3.Një pjesë informative të tilla mund të mbahet nëse çështja e arsyeshme kërkon që konfidencialiteti të respektohet për shkak të ndërmarrjes, dhe informatat e tilla do të përfshihen në raportet e mëvonshme kur më nuk ekziston nevoja për konfidencialitet. Në asnjë rrethanë informacioni nuk mund të mbahet për shkak të interesave të pales përkatëse të ndërlidhur.

4.Faqjen Elektronike (web-faqen), Nërmarrja do ta krijojë dhe në mënyrë të rregullt do të freskohet, nën përgjegjësinë e KE-së, në web-faqe do të parqiten këto informacione si më poshtë:

- 4.1.Dokumentet zyrtare që parashihen dhe raportin për dokumnetet e tilla nga Komisioni i Auditimit.
- 4.2.Raporti nga auditori i jashtëm për pasqyrat financiare që parashihen me Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike.
- 4.3.Listën e kontratave më të rëndësishme të prokurimit që janë lidhur gjatë vitit aktual financiar, që tregojnë natyrën e tyre, çmimin dhe palët tjera, paparagjykim të çfarëdo obligimi të konfidencialitetit që i obligohet fundit. Atëherë kur ndërmarrja të veproj në një treg garues, ajo mund të fshijë të dhënat e ndjeshme komerciale në lidhje me çmimet nga shpalosjet e tilla.
- 4.4.Listën e të gjitha kontratave të prokurimit të lidhura gjatë vitit aktual financiar pa ndjekur procedurat e tenderimit, duke treguar për natyrën e tyre, çmimin, palët e tjera (pa paragjykim të çfarëdo obligimi të konfidencialitetit që i obligohet këtij të fundit) dhe arsyen pse procedurat e tenderimit nuk janë përcjellë.
- 4.5.Çfarëdo padie në gjykatë apo rastet në pritje në lidhje me vlefshmërinë e çfarëdo zgjedhjeje të drejtorit, shkelje të detyrave të mirëbesimit të drejtorëve apo zyrtarëve apo vlefshmëria e çfarëdo vendimi të miratuar nga ana e Bordit të Drejtorëve.
- 4.6.Të gjitha informatat dhe dokumentet e tilla do të shperndahen në paragrafe të ndarë dhe në mënyrë të lehtë për t'i qasur, me lidhje tek dokumnetet tjera kurdo që të jetë e nevojshme, dhe do të përfshihet në një paragrafë të vetëm të web-faqës e cila i dedikohet shpjosjeve publike për çështjet e ndërmarrjes, dhe do të vendoset në një mënyrë të thjeshtë dhe që mund të lexohet lehtë, e cila duhet të ketë një format që mund të printohet lehtë.

Neni 29

Raportimet Financiare

Viti financiar i ndërmarrjes do të jetë i njëjtë me vitin kalendarik.

Neni 30

Detyrime për mos konkurrencë

Drejtorët e Bordit dhe Zyrtarëte Ndërmarrjes, nuk mund të jenë të përfshirë në konkurrencë tregtare kundër ndërmarrjes. Kjo konkurrencë përfshinë, por nuk kufizohet vetëm në punësimin, për të qenë ortak i përgjithshëm, menaxher, drejtor ose anëtar kontrollues ose aksionar në ndonjë shoqëri tjetër tregtare që ushtron aktivitete tregtare konkurruese.

Neni 31

Ndryshimi i Statutit

Ndërmarrja mund të bëjë ndryshimin e statutit të saj në çdo kohë, sipas Ligjit Nr. 06/L-016 Për Shoqërit Tregtare.

Neni 32

Likuidimi i ndërmarrjes

Likuidimi i Ndërmarrjes bëhet sipas mënyrës dhe formës të përcaktuar me ligj.

Neni 33

Dispozitat përfundimtare

Në rast të mos rregullimit eventual të ndonjë çështje me këtë Statut, zbatohet dispozita ligjore të Ligjit Nr.03/L-087 për ndërmarrjet Publike si dhe Ligjit Nr. 06/L-016 Për Shoqërit Tregtare.

Neni 34

Hyrja në fuqi

Statuti për Nërmarrjen publike Stacioni i Autobusëve SH.A. në Glllogoc, hynë në fuqi 8 ditë pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, dhe 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e portokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushteit Lokal.



Kryetari i Komunës:
Ramiz Lladrovci



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit

01 Nr - 020 - 13792 dt. 13/03 2020

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gaz.Zyrt.e Republikës së Kosovës"), nenit 34 të Statutit të Komunës së Gllogocit, nenit 24 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 4 dhe 7 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, të datës 28 tetor 2010, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2020 , të aprovoi këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për formimin e komisionit për vlerësimin e pronave që mund të këmbehen dhe dhënien e rekomandimeve për pronat që duhet të shpronësohen, në parcelën 743/1, në zonën kadastrale
Drenas

Neni 1

Më këtë Propozim Vendim formohet Komisioni për vlerësimin e pronave që mund të këmbehen dhe dhënien e rekomandimeve për pronat që duhet të shpronësohen, në parcelën 743/1, në zonën kadastrale në Drenas në përbërje prej pesë (5) anëtarëve, të cilin Komision e përbejnë tre (3) anëtar nga Ekzekutivi i Komunës të cilët i propozon Kryetari i Komunës, dhe dy (2) anëtar nga Kuvendi i Komunës:

1. _____ -anëtar nga ekzekutivi
2. _____ -anëtar nga ekzekutivi
3. _____ -anëtar nga ekzekutivi
4. _____ - anëtar nga kuvendi
5. _____ -anëtar nga kuvendi

Neni 2

Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlerësimin e të gjitha banesave private që ndodhen në pronën komunale në parcelën 743/1, e të cilat në bazë të m² ka mundësi këmbimi me pronën komunale, në të njëjtën kohë të vlerësohen banesat komunale që duhet të këmben me banesat private.

Neni 3

Komisioni po ashtu ka për detyrë që të vlerësoj që cilat banesa private që ndodhen në pronën komunale në parcelën 743/1, në bazë të m² nuk mund të këmben, e që do të duhet të vazhdohet sipas procedurave të shpronësimit.

Neni 4

Ky këmbim, respektivisht shpronësim, ka për qëllimin lirimin e pronës komunale në parcelën 743/1, në zonën kadastrale në Drenas, me qëllim të realizimit të interesit të përgjithshme ,duke siguruar edhe qëllimin për përmbushjen e interesit publik dhe zhvillimin ekonomik lokal.

Neni 5

Pas aprovimit të këtij propozim vendimi, komisioni brenda një afati të arsyeshëm duhet të vie me propozime konkrete pranë kuvendit të komunës së Drenasit.

Neni 6

Ky propozim vendim hynë në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

 **Kuvendi i Komunës**
Edmond Lladrovci

A r s y e t i m

Duke pasur parasysh Planin Zhvillimor Komunal, Hartat Zonale dhe Planifikimin Urban në Komunën e Drenasit, me qëllim të realizimit të interesit të përgjithshëm, në zonën kadastrale në Drenas, në parcelën 743/1, do të behët këmbimi, respektivisht shpronësimi i banesave pronë private, të cilat ndodhen në pronën e komunës së Drenasit, duke siguruar edhe qëllimin e përmbushjes së interesit publik dhe zhvillimin ekonomik lokal.

Parcela 743/1, në zonën kadastrale në Drenas, në bazë të Planit Zhvillimor Komunal është zonë e planifikuar për ndërtim të lartë.

Andaj, qëllimi i këtij komisioni është që të bëjë vlerësimin e të gjitha banesave private të cilat ndodhen në pronën komunale, e të cilat mund të këmbehen me banesat pronë komunale, në të njëjtën kohë të ipen rekomandimet për banesat private të cilat në bazë të m² nuk mund të këmbehen.

Duke pasuar parasysh këto që u thanë me lartë kërkoj nga ana juaj që të aprovoni këtë propozim vendim me qëllim të realizimit të interesit të përgjithshëm në atë zonë.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01-Nr 030.147 42 dt. 23.04 2020


DRAFT PROPOZIM PËR NDRYSHIM-PLOTËSIMIN E
STRATËGJISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020 - 2024

PRILL 2020

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (i) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gaz.Zyrt. e Republikës së Kosovës"), nenit 34.6 pika të Statutit të Komunës së Drenasit; me nr; 01-110-6904 të dt; 24.09.2008, Dispozitave të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 07/2018 për Planifikimin Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit, në bazë të nenit 4 paragrafi 2 të Ndryshim Plotësimi i Statutit të Komunës së Drenasit me nr: 12-030-19523 të dt;06.04.2018, dispozitave të Udhëzimit Administrativ NR.04/2018 për Transparencën në Komuna, dispozitave të Udhëzimit Administrativ NR.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, dispozitave të Rregullores Nr.01/2017 për Procedurat e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, dispozitave të Rregullores (QRK)Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, dispozitave të Statutit të Komunës së Drenasit, dhe shkresës nga MAPL nr.-IV-020 të dt: 20.03.2020, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datën __.01.2020 të aprovoj:

STRATËGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2024

Ky dokument strategjik përcakton objektivat dhe veprimet e planifikuara komunale që duhet të ndërmerren në fushat të ndryshme të ndërlidhura me politikat të cilat adresojnë problemet e caktuara për periudhën kohore 2020-2024.


Kryetari i Komunës
Ramir Eladrovci



Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024



Komuna e Glogocit

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020 – 2024

Dhjetor 2019

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2024

Përmbajtja

Lista e figurave	4
Ekipi Punues	5
Fjala e kryetarit	6
Hyrje	7
Metodologjia	8
Gjendja Aktuale	8
Ekzaminimi Sektorial	10
Planifikimi Strategjik	10
Të dhënat gjeografike dhe demografike	11
Sektori privat	12
Demografia e bizneseve në Drenas	12
Tregtia	13
Prodhimtaria	13
Sfidat e sektorit privat në Drenas	14
Bujqësia	15
Sektori i pemtarisë dhe perimtarisë	15
Sektori i Bletarisë	17
Sektori i Blegtorisë	17
Arsimi	20
Menaxhimi i arsimit dhe administratës	21
Sigurimi i Cilësisë	22
Mjedisi Shkollor	22
Zhvillimi profesional i mësimeve	24
Shëndetësia dhe mirëqenia sociale	25
Sektori i shëndetësisë	25
Mirëqenia Sociale	27
Ambienti dhe shërbimet publike	28
Menaxhimi i mbeturinave	28
Infrastruktura	28
Kultura, Sporti dhe Turizmi	29
Kultura	29
Sporti	29
Turizmi	30
ADMINISTRATA	31
Trajnimi dhe Zhvillimi	31

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2024

Sistemet e menaxhimit	31
Ofrimi i shërbimeve	32
Vlerat.....	33
Vizioni.....	34
Misioni.....	34
Objektivat Strategjike dhe Hapat Kryesor.....	34

Lista e figurave

- Figura 1 Skema metodologjike
- Figura 2 Popullësia sipas gjinis dhe grupmoshës në %
- Figura 3 Bizneset sipas shpërndarjes, punësimit dhe qarkullimit në %
- Figura 4 Bizneset në sektorin e tregtisë sipas shpërndarjes, punësimit dhe qarkullimit në %
- Figura 5 Bizneset në sektorin e prodhimit sipas shpërndarjes, punësimit dhe qarkullimit në %
- Figura 6 Pemët në tokë të punueshme sipas kulturës
- Figura 7 Pemët në tokë të punueshme sipas kulturës
- Figura 8 Kullotja e bagëtisë sipas pronsisë së kullotave
- Figura 9 Madhësia e kopesë në ekonomitë bujqësore
- Figura 10 Madhësia e tufës së shpendëve në ekonomitë bujqësore
- Figura 11 Numri i përgjithshëm i nxënësve sipas viteve shkollore
- Figura 12 Raporti nxënës/mësimdhënës sipas viteve shkollore
- Figura 13 Personeli shkollor sipas përgaditjes akademike
- Figura 14 Gjendja e objekteve shkollore
- Figura 15 Gjendja e inventarit në shkolla
- Figura 16 Kabinetet e punës / dhe laboratorët sipas disponueshmërisë dhe funksionalitetit në shkolla
- Figura 17 Gjendja e objekteve shëndetësore
- Figura 18 Disponueshmëria e hapsirave të mjaftueshme në institucione shëndetësore sipas kornizës ligjore
- Figura 19 Disponueshmëria e paisjeve medicinale të nevojshme sipas institucioneve shëndetësore
- Figura 20 Numri i vizitave mjekësore në institucionet shëndetësore
- Figura 21 Numri i përfituesve sipas skemave pensionale dhe sociale
- Figura 22 Infrastruktura publike sipas %
- Figura 23 Numri i punëtorëve sipas nivelit të edukimit dhe kategorisë funksionale

Ekipi Punues

Anetarët e Ekipit Komunal për Hartimin e Strategjisë për Zhvillimin Ekonomik Lokal për periudhën afatmesme 2020 – 2024:

Egzona Jetullahi, Drejtor i DHZE
Shehrie Mustafa, Koordinate
Besim Tahiraj, Anëtar
Halime Bardhi – Zenelaj, Anëtare
Shaban Dobra, Anëtar
Afrim Proshki, Anëtar
Hazer Elshani, Anëtar
Shqipe Kuliqi, Anëtare
Agim Kastrati, Anëtar
Ahmet Ahmeti, Anëtar
Safet Hoxha, Anëtar
Lumnije Kijina, Anëtare
Ruzhdi Lestrani, Anëtar
Haki Bekolli, Anëtar
Skenderaj Hasi, Anëtar
Blerim Nika, Anëtar
Haxhi Lladrovci, Përfaqësues i bizneseve
Arben Nika, Shoqeri civile
Florim Hajdari, KEDS
Muhamer Qelaj, KRMM
Ismet Baraliu, KUR
Violeta Baleci, Menaxhere e projektit

Anetarët e ekipit të projektit nga kompania implementuese MDA:

Luan Dalipi – Udhëheqës i ekipit të MDA-së
Hamit Qeriqi – Ekspert në politika lokale dhe zhvillim të qëndrueshëm
Ylber Beqiri – Ekspert i planifikimit strategjik
Bardhyl Musa – Menaxher i projektit
Donika Veseli, Flutra Bislimi - Hulumtuese

Fjala e kryetarit

Të nderuar qytetarë,

Qeverisja Komunale është e përkushtuar që në vazhdimësi të angazhohet për zhvillim të qëndrueshëm, përmes investimeve dhe projekteve në infrastrukturë, bujqësi, përkrahje të bizneseve të reja, arsim, shëndetësi, mirëqenie sociale, kulturë, rini e sport. Shpeshherë, mundësitë buxhetore na kufizojnë që të realizojmë të gjitha projektet e nevojshme për qytetarët dhe bizneset. Megjithatë, ne jemi të përkushtuar që në këto kushte, të bëjmë më të mirën për qytetarët dhe komunën tonë.

Strategjia për zhvillim ekonomik lokal paraqet një dokument strategjik të bazuar në plan të veprimit, që ka për synim zhvillimin ekonomik. Ky plan do të përcaktojë rrugën për të bërë realitet vizionin tonë për Drenasin si çelës i suksesit, për bizneset dhe qytetarët e tij. Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024 është udhërrëfyes për (i) përmirësimin e vazhdueshëm të ambientit të sektorit privat dhe nxitjen e zhvillimit të hovshëm dhe të qëndrueshëm ekonomik, (ii) fuqizimin e qytetarëve për t'a realizuar potencialin e tyre të plotë, përmes sigurimit të mundësive të barabarta në arsim, shëndetësi dhe jetë sociale cilesore, dhe (iii) përmirësimin e vazhdueshëm të menaxhimit njerëzor dhe financiar, bazuar në praktikat e mira ndërkombëtare të qeverisjes lokale.

Besoj fuqishëm që ky dokument strategjik do të shërbejë si orientim për zhvillim të mundësive dhe potencialeve që posedon komuna jonë.

Ramiz Lladrovci

Kryetar i Komunës së Drenasit



Hyrje

Përmes këtij dokumenti strategjik Komuna e Drenasit paraqet vizonin dhe misionin, vendos qëllimet strategjike, objektivat e matshme dhe mjetet për ta orientuar Drenasin drejt një qyteti të zhvilluar. Ky dokument poashtu përbën një detyrë të përbashkët për të zhvilluar Drenasit si qytet funksional, të përkushtuar në përmirësimin e jetës së qytetarëve, në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, rritjen e mirëqenies sociale, ofrimin e shërbimeve publike cilësore, përfshirë arsimin dhe shëndetësinë, si dhe promovimin dhe përkrahjen e aktiviteteve kulturore dhe sportive.

Në 20 vitet e fundit Drenasi është sfiduar nga infrastruktura e dobët, industria e pazhvilluar, objekte shkollore të vjetruara, shërbimeve joadekuade shëndetësore që kanë rënduar edhe më shumë jetën sociale të qytetarëve. Në këtë periudhë, thuajse i tërë buxheti komunal është shpenzuar në rimëkëmbjen e infrastrukturës publike dhe ndërtimit të institucioneve tjera vitale për funksionim normal të komunës.

Aktualisht, në komunën e Drenasit sfida kryesore mbeten zhvillimi i ulët i sektorit të prodhimit, modernizimi i fermave dhe kultivimi i produkteve bujqësore me vlerë të shtuar, siguri i cilësisë në arsim dhe mjedis shkollor, ofrimi i shërbimeve sociale cilësore, rritja e numrit të shërbimeve nga institucione e kujdesit primar shëndetësor, si dhe zhvillimi i kulturës dhe sportit.

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal adreson të gjitha problemet aktuale me të cilat ballafaqohet komuna, dhe ofron zgjidhje praktike që përmirësojnë pozicionin konkurrues të Drenasit në raport me komunat tjera. Në pajtueshmëri me pozicionin e synuar konkurrues dhe mundësi buxhetore janë përcaktuar synimet dhe objektivat për periudhën 2020-2024.

Ky dokument është hartuar nga ekipi i projektit në bashkëpunim të ngushtë me ekzekutivin dhe stafin komunal, përfaqësues të komunitetit të biznesit dhe shoqatave bujqësore, fermerë dhe punëtorë të arsimit, shëndetësisë dhe nxënës.

METODOLOGJIA

Metodologjia

Qëllimi i strategjisë është inkorporimi i saj në drejtoritë përkatëse, nëpërmjet mbledhjes së të dhënave të nevojshme për Komunën e Drenasit si dhe shëndërrimi i të dhënave në informata relevante për marrjen e vendimeve të nevojshme nga ekzekutivi i Komunës.

Strategjia paraqet një platformë strategjike dhe aksionale, që ka për synim zhvillimin ekonomik, për nevojat e sektorëve dhe vendimmarrësve në Komunën e Drenasit.

Për hartimin e strategjisë janë përdorur metoda kualitative dhe kuantitative në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave.

Fazat e përshkruara më poshtë janë kyçe në hartimin e strategjisë në fjalë.



Figura 1 Skema metodologjike

Gjendja Aktuale

Për analizimin e gjendjes aktuale janë mbledhur të dhëna sasiore dhe cilësore në të gjitha drejtoritë e Komunës së Drenasit në mënyrë që të identifikohen të arriturat dhe ngecjet e deritanishme në Komunë. Për të implementuar këtë aktivitet janë përdorur pyetësorë dhe intervista me të gjitha drejtoritë, të cilat kanë ndikim të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të Komunës.

Si fazë fillestare e hartimit të strategjisë është përgaditja e mjeteve për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave. Gjatë kësaj faze janë identifikuar të dhënat e nevojshme për një analizë të mirëfilltë mbi gjendjen e sektorëve ekonomik dhe social. Për këtë janë zhvilluar formularë me të dhënat në vijim:

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2024

Administratë: Lista e stafit më të dhenat: Drejtoria; Kategoria funksionale; Grada; Titulli; Moshë; Paga; Kualifikimi; Gjinia

Arsimi: Numri i nxënësve; Stafi i Angazhuar (administrative/akademik); Numri i stafit akademik sipas përgaditjes shkollore; Numri i nxënësve sipas largësisë së udhëtimit; Infrastruktura bazike (Furnizimi i shkollës me ujë; Ngrohja; Qasja në kanalizim; Gjendja e objektit; Gjendja e Inventarit; Nr i dhomave të mësimi (Klasave); Posedimi i mjetve konkretizuese dhe kabinetet; Mesatarja e notës së nxënësve për shkollën/paralelen; Mesatarja e pikëve në testin e arritshmërisë.

Bujqësia: Sipërfaqja e mbjellur për secilën kulturë bujqësore, numri i fermerëve, numri i ekonomive bujqësore, kategorizimi i tokës, sipërfaqja me kullosa.

Urbanizëm dhe Shërbime Publike: Numri i rrugëve, gjatësia e rrugëve, gjatësia e rrugëve të asfaltuara, kubëzuar dhe në zhavor, gjatësia e kanalizimit fekal, atmosferik, trotuareve, ndriçimit publik dhe ujesjellësit

Zhvillim Ekonomik: Numri i bizneseve të regjistruara, numri i bizneseve aktive, vlera e qarkullimit për sektor dhe nënsektor, numri i punëtorëve për sektor dhe nënsektor; vlera e eksportit për sektor dhe nënsektor;

Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale: Numri i anëtarëve të familjeve të cilët kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale; Pensionet bazike të moshës; Skema e pensioneve për veteranët e luftës; Pensionet kontribut pagues të moshës; Numri i familjeve të cilët kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale; Skema e pensioneve për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës; Pensionet e personave me aftësi të kufizuara; Skema për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara (0-18) vjeç; Pensionet invalidore të punës; Numri i objekteve shëndetësore, gjendja e tyre, numri i vizitave, numri i ofrimit të shërbimeve, frekuenca e shërbimeve sipas viteve.

Kulturë, Rini dhe Sport; Numri i organizatave jo-qeveritare rinore, numri i shfaqjeve dhe performancave artistike në shtëpinë e kulturës; numri i klubeve sportive sipas llojit të sportit

Për hartimin e strategjisë, ekipi i projektit është bazuar në dokumente ligjore siç janë Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Statuti i Komunës, Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Drenasit dhe dokumente të tjera relevante. Poashtu, janë shqyrtuar dhe analizuar strategjitë e ndryshme të prodhuara më herët nga organizata të ndryshme në lidhje me zhvillimin e Drenasit (Strategjia e Zhvillimit Ekonomik 2015-2019, Draft plani zhvillimor i Drenasit 2020-2027). Gjithashtu, janë konsultuar dokumente të tjera shkencore që kanë në fokus turizmin, atraksionet dhe kapacitetet bujqësore të komunës së Drenasit.

Ekzaminimi Sektorial

Në mënyrë që të identifikohen pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë dhe rreziqet në secilën drejtori, është zhvilluar një SWOT analizë përmes intervistave të drejtpërdrejta me drejtorët e drejtorive të Komunës së Drenasit.

Zhvillimi i kësaj analize është përcaktuar nga analiza "7S" përmes së cilës identifikohen kapacitetet dhe ngeçjet e një organizate apo institucioni të caktuar. Analiza 7S identifikon të dhënat si në vijim: *Strukturën e organizatës; Sistemin udhëheqës; Stilin e udhëheqjes dhe vendimmarrjes; Kapacitetet e stafit; Aftësitë e drejtorisë në fjalë; Strategjia e punës; dhe Vlerat e përgjithshme.*

Për më tepër, identifikimi i mundësive dhe rreziqeve për t'u zhvilluar është bërë përmes analizës PESTEL, e cila e vë në korrelacion zhvillimin e Komunës me aspektet: *Politike; Ekonomike; Shoqërore; Teknologjike; Mjedisore; dhe Ligjore.*

Planifikimi Strategjik

Pas procesit të mbledhjes së të gjitha informatave sasiore dhe cilësore janë ndërmarrë hapa konkret rreth hartimit të strategjisë. Pas analizimit të të dhënave të mbledhura nga intervistat, hulumtimeve sekondare, analizimit të të dhënave statistikore dhe analizës sektoriale, është krijuar një pasqyrë që ka reflektuar në gjendjen aktuale në sektorët e analizuar të zhvillimit ekonomik të komunës së Drenasit.

Për hartimin e strategjisë është mbajtur një punëtori dy-ditore me ekipin punues. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte analizimi i të dhënave dhe vendosja e prioritetëve dhe qëllimeve strategjike, objektivave specifike/projekteve/masave që duhet të ndërmerren për realizimin e vizionit të komunës së Drenasit.

Të dhënat gjeografike dhe demografike

Komuna e Drenasit shtrihet në pjesën e Kosovës qendrore, në luginën e Drenicës, 32 km nga Prishtina, 110 km nga Shkupi dhe 230 km nga Tirana. Territori i saj, shtrihet në mes të Rrafshit të Kosovës dhe atij të Dukagjinit. Për nga sipërfaqja, Komuna e Drenasit përfshinë një sipërfaqe prej 275,63km² me një lartësi mbidetare prej 575 m deri 1072 m.

Komuna e Drenasit rrethohet me Malet e Berishës në pjesën Jug- Perëndimore, Kasmaqit në pjesën perëndimore, Qyqavicës në pjesën Veriore, Goleshit dhe Lipovicës (Blinajës) në pjesën Jug-Lindore. Këto male shtrihen në të dy anët e Luginës së lumit Drenica. Drenasi kufizohet me Vushtrrinë dhe Obiliqin në verilindje, me Fushë Kosovën dhe Lipjanin në lindje, në jug me Suharekën, në jugperëndim me Klinën, dhe në veriperëndim me qytetin e Skenderajt.

E një rëndësie të veçantë për komunën e Drenasit është miniera dhe shkërrorja e "Feronikelit". Nëpër këtë komunë kalojnë lumi Drenica dhe Vërbica, uji i të cilave shfrytëzohet për ujitjen e tokave bujqësore.

Nga aspekti i transportit rrugor, komuna e Drenasit lidhet përmes hekurudhës me Fushë Kosovë-Pejë dhe rrugën magjistrale Prishtinë – Pejë, dhe rrugët regjionale R7 Autostrada Prishtinë – Prizren – Tiranë.

Komuna e Drenasit ka klimë të mesme kontinentale me dimra të ftohtë dhe verë të ngrohtë, me temperaturë mesatare vjetore 10.6 °C, ku muaji më i ftohtë është janari me 0.8°C, ndërsa muaji më i ngrohtë është korriku me 20.6°C. Sasia mesatare e të reshurave është rreth 670 mm në vit, kurse lartësia mbidetare është prej 500-650m. Afërsisht gjysma e territorit të komunës së Drenasit gjendet në lartësinë mbidetare rreth 650m, lartësi kjo mjaft e përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë.

Në bazë të vlerësimit të popullsisë të realizuar në vitin 2012, rezulton që numri i popullsisë në Komunën e Drenasit ka qenë 59,752 banorë, nga të cilët 51% i takojnë gjinisë mashkullore, ndërsa 49% gjinisë femërore.




Figura 2 Popullsia sipas gjinis dhe grupmoshës në %

Në bazë të grafikut të paraqitur më lartë, mosha e re 0 - 14 vjeç përbën 29.5 % të popullsisë së Drenasit, kategoria e grupmoshës 15 - 64 merr pjesë me 64.8%, kurse mosha mbi 65 vjeç me rreth 5.6 % të popullsisë së përgjithshme. Nga kjo që u tha më lartë, mund të vijmë në përfundim që grupmoshat e popullsisë 15 – 64 vjeç dominojnë në popullatën e përgjithshme.

SEKTORI PRIMA

Sektori privat

